

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6062
E martë, 14 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Përdorimi i maskave bëhet obligues Faqe 3



PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, DO TË VAZHDOJË EDHE SOT (E MARTË)
INTERVISTIMIN NË GJYKATËN SPECIALE NË HAGË Faqe 4-5

PRESIDENTI THAÇI DO TË INTERVISTOHET EDHE SOT



Pas më shumë se gjashtë orësh benda Zyrës së Prokurorisë së Specializuar në Hagë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se intervistimi i tij do të vazhdojë edhe të martën. Ai ka bërë me dije se në

ditën e parë të intervistimit ka dëgjuar shkëmbimet e teknikaliteteve të ndryshme në mes të avokatit Prosper dhe prokurorëve, të çështjeve sqaruese teknike dhe në të njëjtën kohë edhe ato fillestare, të interesimit

të prokurorëve për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Para se të hynte në ndërtuesën e Prokurorisë së Specializuar për intervistim, Thaçi ka thënë për mediat se beson se nga kjo sfidë do të dalë i suksesshëm

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË PLENARE

MIRATOHET NË PARIM RISHIKIMI I BUXTETIT

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim rishikimin e buxhetit. Me 67 vota për dhe një abstenim, ka kaluar shqyrtimi i parë i Projektitligjit nr. 07/L-014 për plotësimin dhe

ndryshimin e Ligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Hapi i radhës është procedimi në komisionet parlamentare dhe më



pas të dërgohet sërisht në Kuvend për votim përfundimtar

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

TRAFIKU I ORGANEVE
NJERËZORE NËPËR SHPELLA,
A MUND TË JETË
I VËRTETË? (6) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

DHJETË DEPUTETË TË PREKUR ME COVID-19, PROPOZOHEȚ
MBAJTJA E SEANCAVE ONLINE

F. 6

KURTI: KJO QEVERI NUK GËZON
BESIMIN E POPULLIT F. 6

BALAJ-HALIMAJ KËRKON
NGA QEVERIA E SHQIPËRISË
PEZULLIMIN E TAKSËS NË
RRUGËN E KOMBIT F. 2

MINISTRI VELIU DHE DREJTORI I
POLICISË BISEDOJNË PËR
SITUATËN ME COVID F. 5

EKONOMI

VITIN E ARDHSHËM PRITET
INAUGURIMI I PARKUT TË ERËS
NË SELAC TË MITROVICËS F. 9

SINDIKALISTËT E PTK-së, TË
SHQETËSUAR ME VENDIMIN PËR
PËRMBARIM TË BORXHIT
24 MILIONË EURO NDAJ
'DARDAFON'-it F. 8

SPORT

BALLKANI NGUSHTON
NË TRI PIKË DIFERENCËN
ME DRITËN F. 24

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqipëri, 117 raste të reja, dy viktima dhe 68 të shëruar



TIRANË, 13 KORRIK - Gjatë 24 orëve të fundit në Shqipëri janë kryer 585 testime për të dyshuar të prekur me Covid-19, nga të cilat janë konfirmuar 117 raste pozitive. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, shpërndarja gjografike e rasteve është si vijon: 41 raste në Tiranë, nga 9 raste në Shkodër, Kavajë, 7 në Korçë, nga 6 raste Pukë, Lezhë, nga 5 raste Durrës, Kurbin, nga 4 raste në Krujë, Mirditë, Tropojë, 3 në Fier, nga 2 raste në

Kolonjë, Lushnje, Vlorë, Mat, dhe nga 1 rast në Memaliaj, Ura Vajgurore, Pogradec, Kamëz, Berat, Elbasan.

Situata në Spitalin Infektiv vijon të paraqitet e rënduar. Në 24 orët e fundit ka shtim të pacienteve të shtruar, ku aktualisht janë 85 pacientë në spital, 10 pacientë janë në terapi intensive dhe 4 prej tyre janë të intubuar, në gjendje të rëndë.

Në 24 orët e fundit nuk e kanë

fituar dot betejën me sëmundjen 2 qytetarë: Një 70-vjeçare nga Tirana dhe një pacient 66-vjeçar nga Shkodra, me sëmundje bashkëshoqëruese. Në 24 orët e fundit janë shëruar 68 qytetarë, duke e çuar në 2014 numrin e të shëruarve që nga fillimi i epidemisë. Në Shqipëri aktualisht janë 1 462 persona aktivë me Covid-19, kryesisht në Tiranë, Shkodër, Krujë, Durrës.

Balaj-Halimaj kërkon nga Qeveria e Shqipërisë pezullimin e taksës në rrugën e kombit

TIRANË, 13 KORRIK (ER) -
Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka takuar të hënën në Tiranë zëvendëskryeministrin e Shqipërisë, Erion Braçë. Në këtë takim u diskutua për përgatitjet përmes mbajtjen e mbledhjes së dy qeverive që pritet të mbahet në muajin shtator në Shkodër, e ku pritet të nënshkruhen disa marrëveshje të reja mes dy qeverive.
Zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj kërkoi nga qeveria shqiptare që t'i shikojë mundësitet përmes pezullimin e

taksës në rrugën e kombit për qytetarët e Kosovës, për së paku dy muaj, deri më 15 shtator. Po ashtu, ajo ka kërkuar që të eliminohen të gjitha pengesat që po pamundësojnë realizimin e marrëveshjeve të arritura më herët siç janë: funksionalizimi i plotë i pikës doganore në Durrës, unifikimi i kodit doganor, njohja e dokumentacioneve reciproke për eksport dhe import, si dhe kërkjesën e Odës së Farmacistëve të Kosovës për listën e çmimit të barnave.

Zëvendëskryeministrin Braçë u zotua se kërkesën për pezullimin e taksës do ta ngrëhë në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë së Shqipërisë që pritet të mbahet këtë javë. Po ashtu, ai shprehu angazhimin e tij dhe vullnetin për realizimin e plotë të gjitha marrëveshjeve të arritura mes dy vendeve tonë. Zëvendëskryeministria Balaj-Halimaj tha se gjithë përkushtimi i saj do të jetë në funksion të zbatimit të marrëveshjeve të arritura më herët dhe marrëveshjeve të reja që mund të arrihen në shtator e



që për qëllim do ta kenë lehtësimin e jetës së qytetarëve andej e këndeji kufirit. Temë e këtij takimi ishte edhe menaxhimi i pandemisë Covid-19 në dy vendet tona.

Meta kthen ligjin që ndëshkon median

TIRANË, 13 KORRIK - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend Ligjin nr. 73/2020 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 20, datë 20.05.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19’, të ndryshuar”.

Kuvendi, duke miratuar aktin normativ nr. 20, datë 20.05.2020, të Këshillit të Ministrave që paraqitet si një



akt që "lehtësonte" masat kufizuese për jo më shumë se dy persona të pranishëm në një studio epidemie, në fakt përcakton një masë të rëndë administrative fikse, me gjobë 1 000 000 (një milion) lekë ose vendosjen e bllokimit, të pjesshëm ose të plotë, të transmetimit nga media audiovizive si dhe bllokimi dhe/ose ndalimi i funksionimit të pajisjeve, ndërkokë që gjendja e fatkeqësisë natyrore e shpallur me ligj, ka përfunduar vetëm pesë ditë pasi Kuvendi ka miratuar këtë akt.

Sipas argumenteve shoqëruar

të Dekretit, kufizimi për ruajtjen e një distance prej 2 metrash midis të ftuarve në studiot televizive është një masë e detyrueshme dhe e mirëpritur, por sanksioni ndëshkues administrativ është shproporcional. Sipas ligjit, ky sanksion që rrezikon të çojë në ndëshkimin me pa të drejtë të mediave, jo më nga një organ i pavarur, por nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë që përfaqëson vullnetin politik, cenon të drejtën për informim dhe lirinë e shprehjes, të parashikuara në nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës.

Greqia forcon edhe më tej kufirin me Shqipërinë, teste në doganë

TIRANË, 13 KORRIK - Greqia ka vendosur t'i shtojë masat parandaluese për përhapjen e pandemisë në të gjitha pikat kufitare të vendit. Lajmin e ka bërë me dije vetë kryeministri grek Qiriako Micotaqis, i cili ka thënë se testet për Covid-19 do të krv-

hen në disa pika kufitare. Disa nga pikat doganore ku do të shtohen masat janë përmes kufirit me Shqipërinë, përkatësisht në Kakavijë, Maqedoni dhe Bullgari. Në doganën e Promachonas me Bullgarinë është edhe rrreziku më i

madh. Në total, nga 67 797 të kryera nga kjo pikë doganore, prej të cilave vetëm 218 apo 0.35 kanë rezultuar pozitivë. Të gjithë personat që do të hyjnë në Greqi do të duhet ta kenë kryer testin për Covid-19 në 72 orët e fundit dhe të kenë

rezultuar negativë. Një test tjetër do t'u kryhet në doganë, ku do të raportojnë edhe pér vendndodhjen si dhe do ta lënë numrin e kontaktit. Po ashtu, Greqia po shikon mundësinë e ndalimit të grumbullimeve në festivalë dhe ngjarie të ndryshme.



Përdorimi i maskave bëhet obligues

Qeveria e Kosovës të hënën ka miratuar vendime për masat që do të ndërmerren në funksion të luftimit dhe parandalimit të pandemisë Covid-19. Vendimi i parë i miratuar në mbledhjen e së hënës të qeverisë për ndërmarrjen e masave, me qëllim të parandalimit të përhapjes dhe kontrollit të infekzionit Covid-19, është për obligimin e të gjithë banorëve të Kosovës që të bartin maskat për fytyrë në të gjitha aktivitetet jashtë shtëpisive/banesave të tyre, si dhe të mbajnë distancë fizike prej 2 metrash në ambiente të përbashkëta jashtë shtëpisive/banesave të tyre

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 KORRIK - Qeveria e Kosovës, me kërkesë të kryeministrit Avdullah Hoti dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, ka mbajtur mbledhjen korresponduese (mbledhje elektronike), mbledhja e 13, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar vendime për masat që do të ndërmerren në funksion të luftimit dhe parandalimit të pandemisë Covid-19.

Vendimi i parë i miratuar në mbledhjen e së hënës për ndërmarrjen e masave, me qëllim të parandalimit të përhapjes dhe kontrollit të infekzionit Covid-19, është për obligimin e të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës që ta bartin maskën për fytyrë në të gjitha aktivitetet jashtë shtëpive/banesave të tyre, si dhe të mbajnë distancë fizike prej 2 metrash në ambiente të përbashkëta jashtë shtëpive/banesave të tyre. Vendimi obligon, gjithashtu, që të gjitha institucionet publike dhe private të mbajnë dezinfektues për duar dhe maska për fytyrë në vende të qasshme, në hyrje të objektit, të cilat mund të shfrytëzohen nga punëtorët e institucioneve dhe vizitorët.

Është miratuar edhe vendimi për ndërmarrjen e masave për qarkullimin e personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat në: Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë-Kosovë dhe Shtërpcë. Ndalesa fillon të

zbatohet nga data 13 korrik 2020, duke filluar nga ora 21:00 deri në orën 05:00, ndalohet çfarëdo qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat: Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë-Kosovë dhe Shtërpçë. Përjashtim nga ky vendim janë rastet urgjente shëndetësore, nevoja për t'u kujdesur për të sëmurë dhe për persona me nevoja të veçanta, kërkimi i ndihmës nga institucione përkatëse në rastet e dhunës familjare, vdekja e anëtarit të familjes dhe përkujdesja ndaj kafshëve shtëpiake, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia.

Me një vendim të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës është autorizuar ministri i Shëndetësisë për plotësimin e Udhëzimit Administrativ për kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve mjekësore të institucioneve private dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore, duke tejkaluar të gjitha procedurat që përcaktohen me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren për Shërbimin Ligjor Qeveritar. Plotësimndryshimi i këtij akti nënligjor përfshin vetëm përcaktimin e kushteve/kriterieve specifike për të kryer testime molekulare dhe serologjike për Covid-19. Gjithmonë në funksion të masave për parandalimin dhe luftimin e infeksionit me Covid-19, qeveria ka anprovuar edhe



vendimin me të cilin obligohen të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Bosnje e Hercegovinës, që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, duhet të dëshmojnë se nuk vuajnë nga Covid-19, me anë të vërtetimit që dëshmon testin RT-PCR negativ në Sars COV-2, jo më të vjetër se 72 orë nga koha kur paraqiten në kufirin e Republikës së Kosovës. Përjashtimisht nga ky vendim, të gjithë qytetarët e këtyre vendeve, gjatë hyrjes përmes Aeroportit Ndërkontrollor “Adem Jashari” nuk kanë nevojë ta prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR, por ata do të nënshkruajnë një deklaratë ku deklarohen se në afat prej tri orëve do ta lëshojnë territorin e Republikës së Kosovës. Edhe qytetarët e këtyre vendeve që shfrytëzojnë Aeroportin Ndërkontrollor “Adem Jashari” për udhëtimin në vendet e treta nuk kanë nevojë të prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR.

Transportuesit që vijnë nga këto vende në Republikën e Kosovës nuk kanë nevojë ta prezantojnë vërtetimin për testin RT-PCR, por janë të detyruar t'i respektojnë protokollet për transport ndërkombëtar. Edhe transporti i organizuar me autobusë ose linja të rregullta ndërkombëtare në transit nga këto vende nuk duhet ta prezantojnë vërtetimin për testin RT-PCR, por ata nënshtakuajnë deklaratën me të.

cilën obligohen ta lëshojnë territorin e Republikës së Kosovës brenda pesë orëve. Të liruar nga obligimi për prezantim të testit RT-PCR janë edhe diplomatët e huaj nga shtetet e lartçekura që janë të akredituar në RKS, si dhe familjarët e tyre. Gjithashtu, janë liruar nga prezantimi i testit RT-PCR të gjithë shtetasit e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Bosnje e Hercegovinës, të cilët kanë edhe shtetësinë e Republikës së Kosovës, nëse kanë vendbanim në Kosovë. Prezantimin e vërtetimit për test RT-PCR negativ gjatë hyrjes në Republikën e Kosovës, të bërë më së largu para 72 orësh, janë të obliguar ta bëjnë shtetasit e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjë dhe Hercegovinës që kanë të rregulluar lejeqëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Kosovës dhe ata që kanë të caktuar terminë për mjekim në institucione shëndetësore të RKS-së dhe bartësit e dokumenteve personale të lëshuara nga Republika e Kosovës, mirëpo me adresë vendbanimi në njërin nga shtetet e cekura në këtë vendim. Në vazhdim të masave të tjera të luftimit dhe parandalimit të Covid-19, Qeveria ka pezulluar veprimtarinë e çerdheve publike dhe private; aktivitetet rekreative, kulturore dhe sportive të mbyllura në të gjithë territorin e Republikës së

Kosovës. Janë obliguar të gjitha qendrat tregtare në territorin e Republikës së Kosovës që veprimtarinë tregtare ta ushtrojnë prej orës 05:00 të mëngjesit deri në orën 21:00, duke zbatuar në përpikëri kushtet sipas manualit për mbrojtje nga Covid-19 e, mbi të gjitha, mbajtjen e detyruar të maskave dhe krijimin e kushteve për distancë fizike të konsumatorëve

Konsumentoreve.
Vendimi i miratuar nga Qeveria e Kosovës pezullon punën e tregjeve publike të automjeteve dhe tregjet e kafshëve, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pezullon ceremonitë fetare; si dhe ndalon grumbullimin e më shumë se 5 personave në sheshet publike, nevoja dha të përcaktohe.

parqe dhe te ngjashme. Të gjithë operatorët e shërbimeve komunale, financiare, elektronike dhe postare janë të obliguar që të ofrojnë shërbime me orar dhe staf minimal, ndërsa qytetarët mbi moshën 65 vjeç dhe ata me sëmundje kronike (diabet, hipertension arterial dhe sëmundje zemre, sëmundje kronike të mushkërive, pacientët me sëmundje të veshkave, pacientët me imunitet të suprimuar, pacientët onkologjikë etj.) mund të dalin jashtë në ambiente publike vetëm në orët e hershme të mëngjesit nga ora 05:00 deri në orën 10:00 dhe në orët e mbrëmjes nga ora 18:00 deri në orën 21:00.

ShSKUK-ja, me mobilizim të ri për menaxhimin e pandemisë



PRISHTINË, 13 KORRIK - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për riorganizimin dhe mobilizimin e përgjithshëm në të gjitha klinikat e QKUK-së, por edhe spitalet e përgjithshme nën menaxhim të ShSKUK-së. “Të gjitha spitalet janë obliguar që të krijojnë hapësira shtesë, krahas hapësirave aktuale që kanë për trajtim të pacientëve

të dyshuar dhe konfirmuar me Covid-19. Në Klinikën e Neurologjisë shpejt do të janë të gatshme hapësirat për pranim të pacientëve të dyshuar me Covid-19", thuhet në një njoftim të ShSKUK-së.

Për shkak të përkeqësimit të situatës epidemiologjike janë pezulluar të gjitha pushimet vjetore deri më 1 gusht 2020 për të gjithë të punësuarit në institucionet publike nën menaxhim të ShSKUK-së

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, DO TË VAZHDOJË EDHE SOT (E MARTE) INTERVISTIMIN NË GJYKATËN

PRESIDENTI THAÇI DO TË



Pas më shumë se gjashtë orësh brenda Zyrës së Prokurorisë së Specializuar në Hagë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, ka thënë se intervistimi i tij do të vazhdojë edhe të martën. Ai ka bërë me dije se në ditën e parë të intervistimit ka dëgjuar shkëmbimet e teknikalitetave të ndryshme në mes të avokatit Prosper dhe prokurorëve, të çështjeve sqaruese teknike dhe në të njëjtën kohë edhe ato fillestare, të interesimit të prokurorëve për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Para se të hynte në ndërtesën e Prokurorisë së Specializuar për intervistim, Thaci ka thënë përmidat se beson se nga kjo sfidë do të dalë i suksesshëm

EPOKA
ERE**Muhamed KOçi**

PRISHTINË, 13 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, eshtë intervistuar përgjithë orë rresht të hënën në Hagë nga Prokuroria Speciale e Dhomave të Specializuara. Ai do ta vazhdojë intervistimin edhe sot (e martë). "Sot kam dëgjuar shkëmbimet e teknikalitetave të ndryshme në mes të avokatit z. Prosper dhe prokurorëve, të çështjeve sqaruese teknike dhe në të njëjtën kohë edhe ato fillestare të interesimit të prokurorëve për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kështu që, do të vazhdojë nesër.

Faleminderit!", eshtë përgjigjur Thaci.

Para se të hynte në objektin e Gjykatës Speciale, ai eshtë shprehur i gatshëm të përballet me këtë sfidë, duke mohuar të gjitha pretendimet e kësaj gjykate. Ai ka deklaruar se askush nuk mund ta rishkruajë historinë dhe se ky eshtë çmimi përlirinë. "Sot jam këtu përtak respektuar atë që kam endërruar dhe përtak cilën kam luftuar. Një Kosovë e lirë e pavarur e bazuar në të drejtë të barabarta, shoqëri multietnike dhe sundim i ligjit. Jam i gatshëm të përballem me sfidën e re dhe të ngadhnëj përdjalin tim, familjen time, njerëzit e mi dhe shtetin tim. Asnjëri nuk mund ta

rishkruajë historinë. Ky eshtë çmimi përlirinë, ka thënë Thaci para gazetarëve teksha dëgjoheshin brohoritjet "UÇK, UÇK" dhe "Thaci, Thaci" të dhjetëra protestuesve shqiptarë që protestonin para Speciales kundër ngritisë së aktakuzës ndaj tij. Ai ka deklaruar se beson në paqe, drejtësi dhe në marrëdhënie të mirë me gjithë fqinjët. "Besoj në paqe, të vërtetë dhe drejtësinë. Besoj në dialog dhe marrëdhënie të mirë me të gjithë fqinjët. Kosova eshtë storie suksesi dhe jam shumë krenar. Destinacioni i Kosovës eshtë anëtarësimi në BE, NATO dhe miqësi të përherëshme me ShBA-në", ka thënë Thaci.

MSh-ja shpërndan maska mbrojtëse për disa institucione dhe organizata

Prishtinë 13 korrik (ER) - Me qëllim që të ndihmojë në përballimin e pandemisë Covid-19, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë për disa institucione të vendit një numër simbolik të maskave mbrojtëse për personelin e tyre. Gjatë ditës së hënë disa

institucione i kanë pranuar këto maska mbrojtëse, derisa disa të tjera ato do të pranojnë nesër. Maskat janë ndarë për Bashkësinë Islame të Kosovës 500, Ipeshkvinë e Kosovës 250, Rektoratit të UP-së 500, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial nga 150 maska.

Në këtë aktivitet që, ndër të tjera, synon edhe ta promovojojë bartjen e maskës si një masë mbrojtëse të drejtpërdrejtë përgjitet e vendit pavarësisht se në çfarë institucion apo organizatë shërbejnë, do të përfshihen edhe institucione të tjera.



SPECIALE NË HAGË

INTERVISTOHET EDHE SOT



Thaci merr mbështetje nga bashkëluftëtarët e UÇK-së

Në ditën që është intervistuar në Hagë, presidenti Hashim Thaci ka marrë përkrahje nga shumë ish-bashkëluftëtarë. Ata janë shprehur të bindur në pafajësinë e tij dhe pastërtinë e luftës çlirimtare. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se beteja e tij dhe e presidentit Hashim Thaci në Hagë do të

jetë betejë triumfuese e Kosovës. Në profilin e vet në "Facebook", Veseli ka shkruar se Kosova do të dalë triumfuese në këtë betejë pasi lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe e pastër. "Triumphuese do të jetë edhe kjo betejë e Kosovës, në të cilën sërisht do të jemi bashkë me vëllanë tim nga lufta, Hashim Thaci. Sepse, e drejtë, e pastër dhe triumfuese ishte edhe lufta jonë çlirimtare. Prandaj, po, dielli do të lindë përsëri", ka shkruar Veseli. Kurse kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka vlerësuar lart gatishmërinë e presidentit Hashim Thaci që t'i përgjigjet pozitivisht ftesës për intervistim nga Gjykata Speciale. Ai ka thënë se lufta e UÇK-së ka qenë luftë e drejtë dhe e pastër. "Shqiptarët kanë bërë luftë të pastër dhe të drejtë, në mbrojtje të pragut të shtëpisë, dinjitetit dhe atdheut. Në çdo rrethanë përgjatë tërë historisë, kemi dëshmuar pjekuri, guxim, mikpritje e bashkëpunim, e këtë e dëshmon edhe gatishmëria jonë anipse nga pozita e viktimit, t'u përgjigjemi thirrjeve të drejtësisë sado të padrejta qofshin ato. E vlerësoj lart gatishmërinë e presidentit Thaci që t'i përgjigjet pozitivisht ftesës për intervistim nga Gjykata Speciale. Lufta e popullit shqip-

tar, e rreshtuar përkrah UÇK-së, ishte e drejtë, vlera e së cilës, pavarësisht përpjekjeve për ta dëmtuar, nuk do t'i humbë as sot e as kurrë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook", duke shtuar se nuk ka gjykatë që mund ta gjykojë përpjekjen përliri të popullit të Kosovës. "Nuk i kemi ikur asnjëherë ballafaqimit me drejtësinë sa herë ajo e ka kerkuar këtë, pa marrë parasysh pozitata shtetërore, i jemi përgjigjur dhe do t'i përgjigjemi. Nuk ekziston asnjë gjyq që mund ta gjykojë përpjekjen e një populli përtetet jetuar si gjithë të tjerët të lirë në tokën e vet", është shprehur Haradinaj. Më 24 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar se më 24 prill u ka dërguar Dhomave të Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën presidenti Thaci, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe të tjerë, akuzohen për një sërë krimesh kundër njëzimit dhe krimi lufte. Presidenti Thaci më herët ka deklaruar se do të japë dorëheqje nga posti i presidentit nëse aktakuza ndaj tij konfirmohet. Gjykatësi i procedurës para-prake ka maksimum gjashtë muaj, nga muaji prill, përti konfirmuar ose hedhur poshtë aktakuzat.



Ish-zyrtari i lartë amerikan, avokat i Thacit në Hagë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, gjatë intervistimit në Hagë është mbrojtur nga avokati i njohur amerikan Pierre-Richard Prosper. Pierre-Richard Prosper, i lindur më 19 shtator 1963, është avokat amerikan, prokuror dhe ish-zyrtar i qeverisë amerikane. Ai ka shërbyer si ambasador special për Çështje të Krimeve të Luftës nga administrata e ish-presidentit amerikan George W. Bush në periudhën 2001-2005.

Prosper është avokat i diplomuar në Pepperdine University School of Law. Ai ka shërbyer si zëvendësprokuror i Distriktit në Los Angeles, përtet vazhduar si ndihmësprokuror i përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Distriktin e Kalifornisë.

Nga viti 1996 deri më 1998 Prosper ka shërbyer si prokuror për krimi të luftës në Tribunalin Ndërkombëtar Kriminal të Kombeve të Bashkuara për Ruandën. Ai ishte caktuar prokuror udhëheqës i rastit të parë gjyqësor ndonjëherë të gjenocidit nën Konventën për

Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit të vitit 1948. Përveç që e fitoi rastin pas 14 muajsh gjyq, Prosper solli risi në ligjin ndërkombëtar, ku e bindi Tribunalin që ta njohë dhunimin seksual në kohë konflikti si akt gjenocidal dhe krim kundër njëzimit. Prosper ka shërbyer edhe në Departamentin e Drejtësisë, Departamentin e Shtetit.

Në vitin 2001 Prosper ishte nominuar nga presidenti amerikan George W. Bush për ambasador special për Çështje të Krimeve të Luftës. Pasi u konfirmua nga Senati, Prosper u betua më 13 korrik 2001 dhe shërbeu deri në vitin 2005. Si i dërguar i presidentit dhe diplomat senior, Proper ka udhëtuar nëpër botë ku ka zhvilluar negociata diplomatike dhe konsulta me kërë të shteteve, ministra të jashtëm dhe zyrtarë të tjerë të lartë qeveritarë në 60 shtete të ndryshme. Sipas RTK-së, ai ka punuar me parlamente të huaja dhe organizata multilaterale e ndërkombëtare, përtetetet e mbështetje përfpolitikat e Shteteve të Bashkuara.

Ministri Veliu dhe drejtori i Policisë bisedojnë përtetetet me Covid

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka pritur të hënën në takim drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe drejtorin e Operativës, Afrim Ahmetaj.

Në këtë takim u diskutua përvillimet e fundit në vend, përritjen e numrit të qytetarëve të infektuar me Covid-19 si dhe përkonsultimet dhe vendimet e fundit që u morën nga Qeveria e Republikës së Kosovës në lidhje

parandalimin e virusit, në veçanti përzbatimin dhe funksionalizimin sa më të mirë të Planit të ri Operacional të Policisë së Kosovës.

Gjithashtu, në këtë takim u vendos që Policia e Kosovës përsëri të kalojë në orarin 12-orësh përtetetë pasur në kontroll të plotë situatën. Policia e Kosovës do të kujdeset që të shqiptojë dënimë konform ligjit përtetetë gjithë ata qytetarë që nuk i respektojnë masat.

Në fund të takimit, Qalaj e njoftoi

ministrin Veliu se do t'i fitojë në takim të gjithë drejtorët rajonalë të Policisë së Kosovës përtetetetet diskutuar konsultimet dhe vendimet e sotme, si dhe të merren masat e menjëherësme përtetetetet parandalimin e kësaj pandemie përtetetetet hir të ruajtjes së shëndetit publik.

Ministria e Punëve të Brendshme bën thirrje te të gjithë qytetarët që të jenë së bashku në ndihmë të njëri-tjetrit, që të zbatohen udhëzimet e masat e qeverisë e të



professionistëve shëndetësorë, në kundër virusit me sa më pak mënyrë që ta fitojmë luftën dëme.

Kurti: Kjo qeveri nuk gëzon besimin e popullit

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se qeveria e drejtuar nga Avdullah Hoti do të mbahet mend si më e dobëta dhe më e mbapshtë e pasluftës. Kurti ka thënë se Kosova sot është në gjendje të rëndë sepse kriza është e trefishtë: shëndetësia, demokracia dhe ekonomia e vendit tonë janë në krizë të thellë. "Kjo qeveri nuk gëzon besimin e popullit sepse është besëthyer", është shprehur Kurti



EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se kryeministri Avdullah Hoti është vegël e presidentit Hashim Thaçi. Duke folur për qeverinë Hoti, Kurti ka thënë se ajo do të mbahet mend si qeveria më e dobët dhe më e mbapshtë e pasluftës. "Kjo qeveri do të mbahet mend si më e dobëta dhe më e mbapshtë e

pasluftës, krahasimi me të cilën s'do t'i bëjë ndër asnjë qeverie në të ardhmen. Pra, ky ekzekutiv me të cilin nuk bën të krahasohesh - kështu do të mbahet mend qeveria për ata të cilët nuk do ta harrojnë", ka dekluaruar lideri i LV-së.

Kurti ka thënë se Kosova sot është në gjendje të rëndë sepse kriza është e trefishtë: shëndetësia, demokracia dhe ekonomia e vendit tonë janë në krizë të thellë. "Besueshmëria për këtë qeveri

është tejet e ulët. Pritjet nga kjo qeveri, edhe më të ulëta. Zaten, në politikën shtetërore, diçka që nuk është legitime, nuk mund të jetë e vërtetë, andaj as e besueshmëria", ka thënë Kurti. Ai ka shkuar se dështimi i gjithanshëm, e sidomos në

luftimin e pandemisë Covid-19, nuk mbulohet dot me gjendje të jashtëzakonshme e as me kërcënimin për shpalje të saj. "Mbase kjo qeveri edhe s'e lufton dot virusin, sepse ajo është ngritur paligjshëm në kohë virusi e duke iu falenderuar virusit. Kjo

qeveri është e integrueshme te virusi korona", është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se populli i Kosovës ka një refleks padëgueshmëri qytetare ndaj kësaj qeverie të pabesueshme. "Politikanët që e kanë prerë në besë popullin, populli kurrë nuk u beson. Kjo qeveri nuk gëzon besimin e popullit sepse është besëthyer. Prandaj, armiku të cilat qeveria po synon t'ia shpallë gjendjen e jashtëzakonshme është pikërisht populli. Ministri Zezaj i 'Qeverisë Koti' po u kanoset qytetarëve të cilët tashmë i ka shpallur të pabindur e të padisiplinuar. Pra, gjendjen e jashtëzakonshme po duan t'ia shpallin popullit. Por, ne e dimë që sistemi shtetëror, në përgjithësi, nuk ka dështuar, dhe se dështimi ka emra të përvëcëm individësh. Nuk kanë dështuar policia apo mjekësia, por ministrat dhe qeveria", ka thënë Kurti.

Kush nuk respekton masat e qeverisë mund të dënohet deri 12 vjet burgim e 8 000 euro gjobë

Policia e Kosovës nga dita e martë do ta nisë shqiptimin e gjobave për qytetarët që nuk respektojnë masat e dala nga Qeveria e Kosovës kundër koronavirusit

PRISHTINË, 13 KORRIK - Afrim Ahmeti, drejtor i Operacioneve në Policinë e Kosovës, në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se dënimet do të jenë të mëdha. Sipas tij, dënimet shkojnë nga dy vjet deri në 12 vjet burgim, ndërsa për kundërvajtje sipas Ligjt për parandalimin e sëmundjeve ngjitetë deri në 8 000 euro gjobë. "Nga nesër do ta fillojmë shqiptimin e gjobave për shkak se numri i madh i të infektuarve është në rritje dhe po e shohim që nuk po ka alternativë tjetër, pa filluar shqiptimin e gjobave. Ne nga fillimi i zbatimit të vendimeve qeverisë kemi hapur raste sipas Kodit Penal

sipas nenit 249 dhe 250 dhe kemi asistuar inspektorët sanitare, ndërsa tash ne, përvëç asistimit të inspektorëve sanitare dhe rastevë që do t'i aplikojmë sipas nenit 249-250 të Kodit Penal të Kosovës, do të marrim shënimë qytetarëve që nuk i zbatojnë këto masa dhe të njëjtat do të procedohen tek inspektorët sanitare të cilët do të bëjnë këtë paraqitje për ta. Dënimet janë mjaft të mëdha dhe sipas nenit 249 dhe 250 dënimet shkojnë nga dy vjet deri në 12 vjet burgim, ndërsa për kundërvajtje sipas Ligjt për parandalimin e sëmundjeve ngjitetë deri në 8 mijë euro gjobë", është shprehur ai.



Ahmeti, mes të tjera, ka thënë se Policia e Kosovës nga dita e nesërme do ta fillojë punën me

orar prej 12 orësh, si dhe do të ketë prani maksimale nëpër sheshe dhe rrugë kryesore. Ai ka

theksuar se në të gjitha qytetet e Kosovës ka pasur monitorim maksimal nga policia.

Komuna e Gjilanit me donatorët hapin puse për ujë të pijshëm

GJILAN, 13 KORRIK (ER) - Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka marrë pjesë në hapjen e puseve të ujit të pijshëm në Lagjen e Rrushnajave, projekt që është financuar nga Qeveria e Kuvajtit, pas ndërtimit të "Fshatit Social" përfëmijet jetimë, personat me nevoja të veçanta e deri te të moshuarit pa përkujdesje, gratë e sprovuara me dhunë në familje dhe qendren edukuese.

Haziri ka thënë se ky projekt është duke u realizuar në

koordinim me përfaqësuesit e Kuvajtit në Kosovë, KRU 'Hidromorava' dhe Bashkësinë Islame në Gjilan sepse uji është jetë dhe program kryesor ku jemi të fokusuar. "Komuna e Gjilanit është e angazhuar maksimalisht me KRU 'Hidromorava' për ta stabilizuar gjendjen me furnizim me ujë të pijshëm dhe angazhimi është që nga viti i kaluar. Ne, me Bankën Botërore, e kemi bërë zgjidhjen afatgjatë dhe projektin është miratuar në Uashington



nga bordi i drejtoreve para disa javësh dhe tanë negocionin deri në ratifikim të marrëveshjes, për Gjilanin dhe komunitat në region. Ajo që na gjëzon është mbështetja e parezervë e donatorëve nga

Kuvajti, që kanë ndërtuar 'Fshatin Social', i cili është projekti kapital dhe unik në tërë territorin e Republikës dhe më gjërë. Hapja e këtyre puseve është zbutje e problemeve për Gjilanin në pjesën urbane. Në këtë lagje jemi në përfundim të projekteve të infrastrukturës si në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit dhe asfaltimit të rrugëve", ka thënë Haziri.

Mumin Morina, në emër të KRU 'Hidromorava', ka thënë se ky projekt është i rëndë-

sishëm, sepse me këtë po bëhet më i lehtë angazhimi për zgjidhjen e problemit me furnizim me ujë, pas gjendjes së vështirë që ishte Gjilani që nga viti i kaluar, kur vendin e kaploj thatësia e madhe dhe mungesa e reshjeve. Ndërsa në fjalën e tij, Iliaz Mustafa ka falenderuar donatorin dhe është shprehur se kontributi në interes të përgjithshëm është me vlerë të madhe, ngaqë me këtë përfitues janë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve.

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë plenare

Miratohet në parim rishikimi i buxhetit



Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim rishikimin e buxhetit. Me 67 vota për dhe një abstenim ka kaluar shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-014 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Hapi i radhës është procedimi në komisionet parlamentare dhe më pas të dërgohet sërisht në Kuvend për votim përfundimtar

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kuvendi i Kosovës miratoi të hënën në parim Projektligjin për Plotësimin Ndryshimin e Ligjit për Ndarjet Buxhetore. Për projektligjin votuan 67 deputetë, ndërsa një abstenoi. Partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje, nuk votoi. Deputeti i saj, Hekuran Murati, tha se "nuk mund të lejojë që në emr të një ndihme për qytetarët të keqpërdoren miliona euro nga kjo qeveri". Pasi që projektligji në fjalë të miratohet në lexim të dytë, qeverisë do t'i mundësohet zbatimi i Pakos Emergjente Fiskale për situatën e krijuar nga pandemia e koronavirusit. Në Pakon Emergjente Fiskale e cila është në vlerë rreth 180 milionë euro, ndër të tjera, është paraparë që të paguhen punëtorët që nuk kanë punuar nga muaji mars, kur edhe janë paraqitur rastet e para me

koronavirus në Kosovë. Deri më tanë pagesa është bërë vetëm për muajin mars.

Për ta realizuar pagesën për prill dhe maj duhet miratimi i projektligjit për rishikimin e buxhetit.

Projektligji i rishikuar parashev 1 miliard e 788 milionë euro, ndërsa totali i shpenzimeve të rishikuara të buxhetit është 2 miliardë e 620 milionë euro. Buxheti i rishikuar për vitin 2020 adreson të gjitha sfidat e krijuara nga pandemia e koronavirusit dhe gjetjen e mënyrës së financimit të realizimit të dytë, qeverisë do t'i mundësohet

zbatimi i Pakos Emergjente Fiskale për situatën e krijuar nga pandemia e koronavirusit. Në Pakon Emergjente Fiskale e cila është në vlerë rreth 180 milionë euro, ndër të tjera, është paraparë që të paguhen punëtorët që nuk kanë punuar nga muaji mars, kur edhe janë paraqitur rastet e para me

si pasojë e pandemisë dhe, gjithashtu, për ta krijuar Fondin për Rimëkëmbje Ekonomike në shumë prej 385 milionë eurosh. Hapi i radhës është procedimi në komisionet parlamentare

dhe më pas të dërgohet sërisht në Kuvend për votim përfundimtar. "Faleminderit të gjithë deputetëve përmes mbështetjen e rishikimit të buxhetit. Tash duhet shpejt të

procedohet në komisione parlamentare dhe të sillet në Kuvend për votimin përfundimtar", ka shkruar kryeministri Avdullah Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Dhjetë deputetë të prekur me Covid-19, propozohet mbajtja e seancave online

Lidhja Demokratike e Kosovës

ka propozuar në seancën e së hënës që të futet në rend të ditës ndryshimi i Rregullores së Kuvendit, që ua mundëson deputetëve mbajtjen e seancave nga largësia për shkak të shtimit të numrit të personave të prekur me koronavirus.

Propozimin në emr të LDK-së e ka bërë deputetja Besa Gaxherri. "Në emr të LDK-së e ngriti propozimin tuaj si motion që nuk mund të punojmë nga largësia për shkak se deri më tanë 10 deputetë janë të infektuar. Unë besoj se një numër më i madh prej nesh janë të infektuar. Të takohen përfaqësuesit e grupeve parlamentare me një tekst të thjeshtë që seanca të mbahet nga largësia për ndonjë afat të caktuar kohor. Ju kisha lutar znj. kryetare dhe juve deputetë që nuk mund të marrim këtë rezervat tonë lidhur me motivet e kësaj nismë.

Gjithsesi ne do të donim që Kuvendi të ishte funksional. Kjo nismë nuk është një nismë përtu' keqpërdorur. Ne si grup parlamentar kemi nevojë konsulta më tepër që kur ta jepim mendimin tonë. Ne nuk

thënë Gaxherri.

Këtë çështje kryeparlamentarja Vjosa Osmani ka thënë se e ka ngritur që nga muaji mars. "Lidhur me përpjekjet që janë bërë për ndryshim të rregullores ka qenë propozimi që nga marsi që të mbahen seancat online. Për komisionet kjo mundësi ekziston. Ne po i mbajmë mbledhjet e kryesisë përmes platformës ZOOM. Për seancë duhet patjetër të ndryshojë rregullorja. Mua më është dashur konsensusi i grupeve parlamentare", ka thënë Osmani.

Nga Lëvizja Vetëvendosje, shefi i grupit parlamentar, Rexhep Selimi, ka thënë se nuk mund ta ofrojnë mbështetjen që kjo pikë të futet në rend të ditës. "Ne kemi me të drejtë rezervat tonë lidhur me motivet e kësaj nismë. Gjithsesi ne do të donim që Kuvendi të ishte funksional. Kjo nismë nuk është një nismë përtu' keqpërdorur. Ne si grup parlamentar kemi nevojë konsulta më tepër që kur ta jepim mendimin tonë. Ne nuk

mund ta ofrojmë mbështetjen që sot të futet në rend të ditës", ka thënë ai.

PDK-ja ka thënë se në këtë situatë në të cilën ndodhet vendi duhet të modelohet një zgjidhje që i mundëson Kuvendit që të jetë funksional. "Po u pamundësohet deputetëve që për shkak të gjendjes shëndetësore të votojnë në seancë", ka thënë shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza.

AAK-ja përmes shefit të grupit parlamentar, Daut Haradinaj, ka thënë se kanë propozuar edhe ditë më parë votimin online. "Edhe sot jemi një deputet minus. Do ta jepim përkrahjen", ka deklaruar Haradinaj. "Ju lus, deputetë, që të gjithë bashkërisht të mund të zgjedhim një zgjidhje sa i përket mënyrës së votimit. Deri të mërkurën kur e kemi mbledhjen e kryesisë, ju lus të vini me propozime", ka thënë në fund kryeparlamentarja Vjosa Osmani.

Sindikalistët e PTK-së, të shqetësuar me vendimin për përmbarim të borxhit 24 milionë euro ndaj 'Dardafon'-it

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 KORRIK - Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së ka lëshuar një reagim në lidhje me vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës për përmbarim/realizim të borxhit mbi 24 milionë eurosh ndaj kompanisë "Dardafon.net".

"Dardafon.net" kishte fituar lëndën në Arbitrazh në vitin 2016, ndërsa i është njohur e drejtë për përmbarim/realizim të borxhit. "FSP-PTK me shqetësim të madh mori lajmin se kompanisë zhvatëse 'Dardafon.net' i njihet e drejtë për përmbarim/realizim të borxhit mbi 24 milionësh nga Arbitrazhi i viti 2016. Siç e kemi thënë edhe më herët, vazhdimisht përmes të gjitha formave të lejuara të organizimit sindikal, institucionet e drejtësisë në Kosovë duhet ta

vendosin drejtësinë lidhur me këtë kontratë korruptive. Institucionet e drejtësisë nuk duhet të lejojnë që një kontratë korruptive të vazhdojë ta shkatërrojë Telekomin e Kosovës edhe pas përfundimit të saj. Gjendja e rëndë në Telekomin e Kosovës në masë të madhe ka ndodhur për shkak të kësaj kontrate. 'Dardafon.net' jo që vetëm ia ka zhvatur Telekomit miliona euro gjatë 10 vjetëve, por tash do t'ia zhvatë Telekomit edhe miliona të tjera përmes ekzekutimit të vendimit të Arbitrazhit", është thënë në reagimin e FSP-PTK-së.

Po ashtu, FSP-PTK u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë se nuk duhet të lejojnë që "një kontratë korruptive" ta shkatërrojë Telekomin e Kosovës. "Ne ua bëjmë me dije institucioneve të drejtësisë, se njerëz të caktuar kanë dëshmuar qëllimisht kundër Telekomit të

Kosovës në Arbitrazh vetëm pëta dëmtuar atë. Prandaj, ne kërkojmë drejtësi rreth kësaj kontrate. Ne kërkojmë të hulumtohet dhe të nullifikohet ky vendim i Arbitrazhit, sepse edhe dërgimi i saj në Arbitrazh ka pasur shkelje të rënda procedurale dhe anashkalim të legjislacionit vendor. Ne jemi informuar për vendime të tillë nëpër botë", theksohet në këtë reagim.

FSP-PTK ka theksuar se, përveç kësaj, "Dardafon.net" duhet ta dijë se cenimi i funksionimit të Telekomit të Kosovës është ceni i sigurisë kombëtare, pasi e prek drejtëpërdrejt funksionimin e institucioneve vitale të shtetit (AKI, Policia, Ushtria, Qeveria, komunat etj.). "Ne i bëjmë thirrje 'Dardafon.net', largo duart nga tentimi i vjedhjes së pronës publike, se mjaft e ke zhvatur për 10 vite. Përndryshe, do të

ballafaqohesh me 2 350 sindikalistë, familjarët e tyre dhe të gjithë opinionin publik që ia duan të mirën Telekomit të Kosovës, të cilët do t'i përdorin të gjitha format e organizimit sindikal për ta mbrojtur Telekomin e Kosovës. FSP-PTK ju paralajmëron se çdo tentim që të bllokohen xhirollagaritë me përmbarim në këtë kohë të rëndë për Telekomin e Kosovës dhe për vetë vendimin që gjendemi në pandemi, do të sjellë kaos social, ku as ju si zhvatës 10-vjeçar nuk do të dilni fitimtar", thuhet në reagimin e FSP-PTK.

Rreth katër vjet me parë "Z-Mobile" (Dardafon) iu drejtua Arbitrazhit pasi pretendonte se Telekom i Kosovës kishte shkelur marrëveshjen pasi refuzonte t'i ndajë numra shtesë dhe t'i ofronte shërbime 3G dhe 4G. Për këtë çështje, në fund të vitit 2016 pati vendosur Tribunali

i Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare, e cila e obligonte Telekomin të paguante mbi 30 milionë euro gjobë për shkak të shkeljes së marrëveshjes. Muaj më vonë ish-kryesefi i Telekomit, Agron Mustafa, së bashku me pronarin e Z-Mobile, Blerim Devollit, patën dalë para mediave me arsyetimin se kanë arritur marrëveshje dhe se "Devollët" do ta falnin borxin e Telekomit që i obligonte Arbitrazhi. Mustafa pati thënë se janë shpëtuar mbi 32 milionë euro, ndërsa marrëveshja e arritur atëkohë në mes të Postës së Kosovës dhe Z-Mobile parashihte që të paguhen vetëm shpenzimet për arbitrazh, por që Mustafa nuk pati pranuar të tregojë për shumën që do të paguajë. Përkundër kësaj, lënda u dërgua në Departamentin Ekonomik të Gjykatës Themelore në Prishtinë.



Ministri Krasniqi me përfaqësuesit e OAK-ut diskutojnë për bizneset

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), me të cilët ka diskutuar për

bashkëpunim për gjetjen e mundësive për ta tejkular gjendjen aktuale që ka shkaktuar pandemia në biznese. Po ashtu, në takim u bisedua edhe rreth pakos fiskale si do të ndihmohen

bizneset për t'i tejkular vështirësitë me të cilat po ballafaqohen aktualisht. Ministri Krasniqi ka rithëksuar se do të jetë gjithherë përkrahës i bizneseve pasi që nga to varet edhe zhvillimi

ekonomik i vendit. Në fund, ministri Krasniqi e ka falënderuar kryetarin e OAK-së, Skënder Krasniqin, për aktivitetin e pandalshëm në kreativitetin e përfaqësimit të bizneseve.



Vitin e ardhshëm pritet inaugurimi i Parkut të Erës në Selac të Mitrovicës

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka vizituar të martën Parkun e Erës në Selac të Komunës së Mitrovicës. Ky projekt i energjisë së erës synon kapacitetin e përgjithshëm prodhues prej 105 megavatesh. Kjo energji do të distribuohet në Vushtrri përmes linjës së transmisionit 110 kV të gjatë 19 kilometra që, gjithashtu, është pjesë e investimit të projektit dhe do t'i transferohet KOSTT-it. Ky projekt është paraparë që të përfundojë deri në prill të vitit 2021 dhe do të ketë jetëgjatësinë së paku 25 vjet

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka vizituar të martën Parkun e Erës në Selac të Komunës së Mitrovicës, që është projekt i

"SOWI Kosova" Sh.P.K. ndërmarrje e përbashkët kosovare, gjermane dhe izraelite për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Në këtë vizitë kryeministri Hoti ishte i shoqëruar nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, dhe ministri i Bujqësisë,

Besian Mustafa, i cili para pesë vjetësh e kishte iniciuar këtë projekt, kur ishte në të tjera kënaqur që e shohim një investim kaq madhor edhe sa i përket nivelit të investimeve edhe konsorciumeve që janë bërë bashkë të investitorëve

gjermanë dhe izraelitë, financuar nga banka siç është BERZh, Banka Slovène dhe investitorët e tjera, në një sektor që është i rëndësishëm vërtet strategjike për vendin. 105 megavatë energji elektrike që do të lëshohen në rjet në vitin e ardhshëm, është një investim shumë i rëndësishëm përvendin", u shpreh Hoti.

E rëndësishme, siç potencoi kryeministri Hoti, është fakti se janë investitorë me emër evropianë dhe botërorë dhe se ky është një sinjal shumë i fuqishëm që Kosova është një destinacion i sigurt përvendime dëshironë se prania këtu bashkë me ministrin dhe

ambasadorin është tregues përkompaninë dhe investitorin se do ta kenë mbështetjen e qeverisë, për t'i lehtësuar të gjitha procedurat, në mënyrë që investimi të jetë i suksesshëm.

Kryeministri Hoti, po ashtu, ka deklaruar se ndihet i impresionuar me statistikat që u prezantuan, që shpejtësia e erës është më e madhe, rrëth 9 metra në sekondë, që është më e madhe se në shumë vende të Gjermanisë, që e bën këtë projekt shumë fizibël për prodhimin e energjisë. Hoti, po ashtu, ka thënë se pret që në prill të vitit të ardhshëm të janë këtu bashkë dëshironë se presin shiritin e këtij projekti shumë të rëndësishëm.

Ky projekt i energjisë së erës, i cilësuar me standarde të larta pozitive dëshironë me ambientin, synon kapacitetin e përgjithshëm prodhues prej 105 megavatesh. Kjo energji do të distribuohet në Vushtrri përmes linjës së transmisionit 110 kV të gjatë 19 kilometra, që gjithashtu është pjesë e investimit të projektit dhe do t'i transferohet KOSTT-it. Projekti përbëhet nga 27 turbina të erës me kapacitetin e përgjithshëm prej 105 megavatesh. Në realizimin e tij janë përfshirë edhe Notus Energy, General Elektrik dhe BERZH.

Ky projekt është paraparë që të përfundojë deri në prill të vitit 2021 dhe do ta ketë jetëgjatësinë së paku 25 vjet. Në realizimin e këtij projekti do të angazhohet fuqi punëtore dëshironë se ndikojë në zbutjen e papunësisë. Kosova po synon objektivin e prodhimit të energjisë së erës në kapacitetin e 25 për qind të prodhimit të përgjithshëm.



Shqyrtohen kërkesat e dy investitorëve strategjikë

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Komisioni Ndërministror për Investime Strategjike shqyrtoi kërkesat e dy investitorëve strategjikë. Në Ministrinë e Tregtisë dëshironë se takua Komisioni Ndërministror për Investime Strategjike përmes tij shqyrtuar dy kërkesat e investitorëve strategjikë.

Në cilësinë e kryesuesit të Komisionit Ndërministror për Investime Strategjike, ministri i Tregtisë dëshironë, Vesel Krasniqi, ka thënë se në këtë takim u shqyrtuan dy kërkesa nga subjektet investuese, të cilat në parim i kanë plotësuar kushtet e nevojshme përmarrjen e statusit të investitorit

strategjik.

Ministri Krasniqi bëri të ditur se sipas vlerësimit të këtij komisioni subjektet investuese që kanë aplikuar përmes statusin në fjalë janë njëri nga sektori i energjisë dhe tjetri nga sektori i bujqësisë, ku të dy bashkë kapin vlerën e investimit rrëth 50 milionë euro.

Në këtë takim komisioni mori vendim edhe përkrijimin e dy grupeve operacionale që do ta bëjnë vlerësimin profesional të këtyre dy subjekteve aplikuese, ndërsa pas vlerësimit procesi do të vazhdohet në përpunëjje me Ligjin për Investimet Strategjike të Republikës së Kosovës.



Bahtiri kërkon nga MPB-ja ta bëjë funksionale Qendrën për Pajisje me Dokumente

MITROVICË, 13 KORRIK (ER) - Nga e hëna, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka mbyllur Qendrën për Pajisje me Dokumente në Komunën e Mitrovicës për shkak se një zyrtar ka rezultuar pozitiv me virusin Covid-19. Pas këtij njoftimi nga ana e MPB-së, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka kerkuar nga ministria në fjalë që të angazhojë staf shtesë në mënyrë që kjo qendër të hapet, pasi që është shumë e nevojshme që qytetarët tanë t'i marrin shërbimet që u duhen për dokumente të identifikimit si dhe vule apostile/verifikuese. Qendra për Pajisje me Dokumente në Komunën e Mitrovicës që nga java e kaluar ka dhënë shërbime edhe përvula apostile/verifikuese jo vetëm për qytetarët mitrovicas, por edhe për qytetarët e rajonit, prandaj është më se e rëndësishme që kjo qendër të bëhet urgjentisht funksionale.



Filloi hapja dhe rregullimi i një rruge në Tërpezë



MALISHEVË, 13 KORRIK (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve në infrastrukturën rruore, të hënën në fshatin Tërpezë të Malishevës, përkatësisht në lagjen e "Muhamherëve", ka filluar hapja, zgjerimi dhe rregullimi i rrugës "Blerim Krasniqi". Fillimin e punimeve në këtë rruge e ka parë nga afér edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Urbanizimit, Ahmet Morina dhe ai i Gjeodezisë, Bashkim Krasniqi. Kryetari Begaj dhe drejtoret komunalë janë takuar edhe me banorët e kësaj lagjeje, të cilët i

kanë uruar për fillimin e punimeve për rregullimin e rrugës kryesore të kësaj lagjeje. "Ne jemi duke punuar në vazhdimësi që përmes rregullimit të infrastrukturës, të krijojmë kushtet sa më të mira për të gjithë banorët, në çdo fshat e lagje, në mënyrë që lëvizja dhe jetesa të jetë sa më e lehtë për të gjithë", ka thënë Begaj. Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë se rruga "Blerim Krasniqi", pjesa ku do të rregullohet ka një gjatësi prej 500 metrave dhe mundësohet nga buxheti i komunës, në kuadër të buxhetit të ndarë për investime kapitale.

Kompania 'Kastrati' dhuron 1 100 maska për komunën e Drenasit

DRENAS, 13 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim përfaqësuesin e kompanisë së derivateve "Kastrati", Kushtrim Kastrati. Me këtë rast, Kastrati ka dhuru-

ar 1 100 maska për mbrojtje nga Covid-19. Kryetari Lladrovci ka falenderuar Kushtrim Kastratin për këtë donacion të ofruar dhe ka theksuar se përkrahja që po bëhet nga bamirësit në këtë

kohë pandemie është shumë e mirëseardhur për tekalimin dhe parandalimin e luftimit me Covid-19. Komuna e Drenasit ka njoftuar se maskat do të ndahen për institucionet komunale.



Trajtohen profesionalisht qindra qen endacakë në Ferizaj

Ferizaj, 13 korrik (ER) - Trajtimi i qenve endacakë është duke u bërë në vijimësi në Komunën e Ferizajt. Është qendra e trajtimit profesional e qenve endacakë e cila po strehon dhe ofron trajtimin e tyre. Për këtë, të hënën drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë, Burim Bajrami, ka vizituar këtë qendër. Aty është bërë me dije se ekspert profesion-

ale të kujdesit janë duke trajtuar qentë endacakë duke bërë kastrimin, sterilizimin, vaksinimin dhe dehelmitizimin e tyre. "Ndonëse kjo kompetencë aktualisht është në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, nga viti i ardhshëm trajtimin e qenve endacakë do ta bëjë niveli lokal, në këtë rast edhe Komuna e Ferizajt. Drejtori

Bajrami tha se ky proces është i rëndësishëm jo vetëm për shëndetin e sigurinë e qytetarëve, por edhe kujdesin ndaj shëndetit të qenve, trajtimin profesional të së cilës po e bën kjo qendër. U bë e ditur se qindra qen endacakë po trajtohen vazhdimisht përmes kësaj qendre", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.

TRAFIKU I ORGANeve Njerëzore Nëpër SHPELLA, A MUND TË JETË E VËRTETË? (6)



Shkruan: Kudusi LAMA

Duhet ditur se pa UÇK-në dhe luftën e saj çlirimtare Kosova kthehet në një parcelë të gjithkujt, ndoshta edhe serbe. Por askush nuk duhet të mashtrohet prej atyre që kanë dëshirë të ndodhë kjo. Kosova përjetësish do të jetë e lirë dhe me histori të shenjtëruar mbështetur mbi luftën e të gjithë brezave, përfshirë edhe luftën finale, Luftën Çlirimtare dhe Ushtrinë që e barti atë luftë.

Tani flitet shumë për transplantimin e organeve njerëzore. Më parë kisha menduar se kjo praktikë në trupin e njeriut është shumë e vështirë dhe bëhet në raste të veçanta e me shumë analiza. Dhe realisht kështu mendoj edhe aktualisht, se nuk është e lehtë të bësh transplantimin e organeve njerëzore.

Por ja që kur po lexojmë politikisht, po duket se gjithçka është e lehtë. Një ditë po bisedonim me një grup intelektualësh dhe njëri prej tyre po thotë se një ministër kishte vjedhur mbi 200 milionë euro.

- Janë shumë - i thashë.

- I kanë parë në çantën e dorës në aeroport duke ikur për jashtë shtetit, - ishte përgjigja e tij.

- Më vjen keq që nuk e di se paraja është letër dhe letra bëhet prej druri, - ia ktheva unë.

- E di, e di - u përgjigji ai.

- Nëse e di, duhet të dish edhe se druri ka peshë dhe volum. E 200 milionë euro, po të ishin vetëm 500-she, kanë një masë prej një metër kub. Kurse nëse janë 100-she e 50-she, do të duhet të ngarkohen kamionë të tonazhit të rendë, e ato nuk mund të futen në një çantë dore siç pretendoni ju - e sqarova.

- Ndoshta keni të drejtë - e uli zërin bashkëbiseduesi.

E solla këtë shembull për të arsyetuar se vijnë momente kur edhe njerëz të shkolluar bien në kurthin e thashethemeve dhe flasin pa llogari e bëhen pre e injorimit. Dhe jam i bindur se sot shumëkush është nën atë kurth.

Kështu është edhe kjo puna e trafikimit të organeve njerëzore nëpër male e duke i siguruar ato duke prerë njerëz nëpër shpellë, siç pretendon i quajturi Dick Marty, në raportin e tij, i cili ka marrë përgjegjësinë të mos jetë vetëm jurist, siç pretendon se është, por të jetë edhe shkencëtar i mjekësisë, nga më të fuqishmit, që të argumentojë se njerëzve mund t'u hiqen

organet nëpër male e të futen nëpër xhepa, e kur të ketë nevojë dikush, mund t'i shiten nëse do të mund të merren vesh në pazar. Akuza që diktoi ngritjen e një gjykate ndërkombëtare e që po tenton ta njollos historinë e një populli të tërë.

Por realisht këto janë për të qeshur. Ama, në kushtet tonë, kur po merren shumë seriozisht dhe po na akuzohen djemtë e luftës, me tendencë për ta quajtur gjithë UÇK-në një organizatë kriminale, është vërtet për të qarë.

Ndonjëherë në të ardhmen e largët mund vijë një kohë, që me një eshtër të vdekuri të ndërtohet plotësish njeriu, ndoshta edhe me mendimet, dijet dhe njohuritë që ka pasur kur ka jetuar, pse jo edhe para dhjetë mijë vjetësh. Por sot jemi në kushte e kohë të tjera.

Unë kam lexuar se: "Shumë njerëz të cilëve iu nevojitet një transplantim veshke iu duhet të kalojnë vite të tëra me dializë në pritje që një organ i përshtatshëm të vihet në disponim për ta".

Si ka mundësi, që është kaq e lehtë në lapsin e Dick Martyt, për të formuluar akuza? Si është e mundur që në institucionet evropiane të ngrihen organë ndërkombëtare për të bërë "drejtësi" me një "shkencë" të tillë? Kjo duket absurde. Kur të tjerët thonë se ka shumë vështirësia për t'u realizuar një proces i tillë transplantimi, na del se është aq e thjeshtë, sa mund të kryhet edhe nga një njeri i çfarëdoshëm, ani pse nuk është as mjek e as punonjës i shërbimit shëndetësor. Çdo njeri mund të zërr një njeri tjetër që e mund në rrugë, ta ulë poshtë, ta hapë në gjoks, t'i marrë zemrën ose veshkat apo ndoshta edhe organe të tjera, dhe të largohet. Duhet të ruhen njerëzit kur të shikojnë në rrugë ndonjë njeri që është më i fuqishëm se ata, pasi përbën rezik për t'i grabitur organet jetësore. U bë kjo punë, si puna e

hajdutëve të xhepave në autobusët urbanë në Tiranë në vitet '90. Ndoshta ndonjë ditë do të dëgjojmë se një i tillë i ka marrë veshkën apo zemrën ndonjë qytetari duke lëvizur nga Kombinati në Kinostudio me autobusin urban.

Mua realisht më lind një pyetje: Trafiku i organeve njerëzore, a mund të jetë i vërtetë? Dhe me duket se në kushtet e UÇK-së kjo praktikë nuk mund të jetë e vërtetë. Dhe jam i bindur se në atë kohë as që i kishte shkuan në mendje ndonjë luftëtarë se mund të ekzistonte ndonjë praktikë e tillë.

Unë e kuptoj se ai që ka përvojë për krimë, kujtohet për gjithçka. Dhe shkoj se kudo ku janë masive krimet serbe, po lindin edhe krimë shqiptare. Pra, po transmetohet si përvojë. Por, jo si përvojë për t'i përsëritur krimet, por për të krijuar alibi kimesh, që të rregullohen interesat e serbëve.

Seria është përkujdesur me kohë që krimet t'ia adresojë UÇK-së dhe të krijojë terren të përshtatshëm për ta kriminalizuar atë. Por askush nuk e ka menduar se mund të arrijë deri tek e pamundura. Praktikisht dhe shkencërisht konsiderohet e pamundur që të merren organë jetësore njeriu nëpër pyje.

Politikisht po, qenka e mundur, prej kur Karla Del Ponte dhe Dick Marty morën përsipër të janë liderë të shkencës mjekësore megjithëse janë juristë.

Ne i njohim shpifjet serbe dhe, siç themi ne shqiptarët, për serbët "pjell edhe mushka", por që të pjellë mushka në Zvicër, këtë nuk e kisha menduar kurrë, pasi gjithnjë kam menduar se atje peshohet me kujdes edhe puna, edhe fjala. Por, ja që fjala doli se u shprehka edhe për interesa banale personale, duke vënë në lëvizje një Evropë të tërë.

Sidoqoftë, ne duhet të sqarojmë në radhë të parë veten tonë, se

në kushtet e Luftës Çlirimtare të Kosovës, askush nuk ka pasur mundësi dhe as njohje për të bërë monstruozitë të tillë, jo më t'i ketë kryer.

Në radhë të parë se një aktivitet i tillë ishte i pamundur, pasi UÇK-ja ishte nën vëzhgim të gjithë organizatave të inteligjencës së shteteve të botës dhe të gjitha mediave botërore.

Së dyti, se ajo ishte duke vepruar në Kosovën e pushtuar dhe në Shqipëri, që ishte një shtet i cili nuk kishte marrë përsipër asnjë obligim për ta ndihmuar UÇK-në dhe luftën e saj, përkundrazi në gjithë rrugëkalimet ishin ngritur postbilloqe policie, të cilët inspektoheshin, përvëç prej shtetit, edhe prej ekipeve të dendura të OSBE-së.

Së terti, në atë kohë ishte problem për të gjetur një mjek apo punonjës të shërbimit shëndetësor, për t'i lidhur plagët e luftëtarëve e jo më për të krijuar mundësi për marrje organesh njerëzore.

Së katërti, ishte problem, të merreshim me krijimin e manipulimit të faktave. Por që të manipulohet një luftë dhe një plejadë luftëtarësh, vetëm pse prishën interesat e Serbisë me luftën e tyre, këtë nuk duhet ta lejojmë kurrë, pavarësisht se është bërë pjesë e kësaj loje të ndyrë edhe një pjesë e politikës evropiane, duke u mbështetur në shpifjet e paguara të eksponenteve të Serbisë që kanë depertuar në gjirin e saj.

Por, mbi të gjitha, nëse do të konsultojmë literaturë të mirëfilltë të mjekësisë mbi transplantimet e organeve jetike njerëzore, do të shohim se si marrësi i organit ashtu edhe dhuruesi duhet t'u nënshtronë disa parimeve që kërkojnë zbatim korrekt të gjitha kërkësave përvlerësimin e riskut, që fillojnë me njohjen e mirë të marrësit dhe dhuruesit në jetën e tyre shëndetësore, duke vlerësuar se sa ata kanë qenë të shëndetshëm në jetën e tyre, sa u janë nënshtruar mjekimeve, si e kanë gjendjen e forcës së kockave e të muskujve, si janë ushqyer, çfarë infeksionesh kanë kaluar etj. Po kështu, vlerësohen edhe masat për parandalimin e infeksioneve, përgatitjen e rrugëve të lidhjeve etj. Cilësia e organeve, lidhjet e grupeve të gjakut dhe indeve etj. Dhe për të gjitha këto e mjaft probleme të tjera që shoqërojnë këtë proces, kërkojnë laboratorë shumë të specializuar (sidomos ato, të cilët përcaktojnë pajtueshmërinë indore).

Për të marrë njohuri për këto çështje praktikisht, rekmandoj që të konsultohen:

- Heart Disease 6th EDITION, (Sëmundjet e zemrës, botimi i gjashtë), botim i vitit 2001. Në ShBA - anglisht.
- NEPHROLOGIE (Nefrologjia), me autor Gabriel Richet, botim i vitit 1989 në janar, në Paris, Francë - frëngjisht. (Vijon)



Maqedonia e Veriut regjistron ulje të numrit të rasteve me koronavirus

SHKUP, 13 KORRIK - Maqedonia e Veriut të hënën regjistroi tri viktima nga koronavirusi, 88 të infektuar të rinj dhe 123 të shëruar. Shifrat e viktimate dhe të rasteve të reja, të cilat i referohen testimit të 973 mostrave, janë më të ulët në dy javët e fundit. Në lidhje me viktimat e fundit, ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë së Veriut, Venko Filipçë, tha se dy janë nga Shkupi dhe një nga qyteti i Shtipit. Sipas tij, ato kanë qenë të mos hënë mbi 60 vjeç dhe me sëmundje të tjera kronike. Me këto viktima, numri i përgjithshëm i personave të vdekur nga koronavirusi në Maqedonië e Veriut shkon në 385 - shumica prej tyre janë nga Shkupi, Struga, Tetova, Kumanova dhe Shtipi.

Sa iu përket të të infektuarve të rinj, Shkupi është në vendin e parë me 30 raste të reja, Shtipi 13 dhe Struga 11. Numër më i vogël i të infektuarve është regjistruar

në 13 qytete të tjera. Sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë në Maqedonië e Veriut, numri më i lartë nga 123 të shëruarit është shënuar në Shkup, 70 raste dhe në Tetovë 31 raste. Sipas të dhënave të publikuara, pas një periudhe të gjatë, numri i të shëruarve është më i lartë se i të infektuarve, përkatësisht nga 8 197 të regjistruar me koronavirus, të shëruar janë 4 326, ndërsa raste aktive janë 3,486.

Deri më tanë, në Maqedonië e Veriut janë kryer 78 133 teste. Ministri i Shëndetësisë, Filipçë, në një postim në "Facebook", njoftoi për përgatitjet e institucioneve shëndetësore për, siç tha, "valën e re të koronavirusit në vjeshtë". "Kryetarët e 16 komunave kanë mbështetur propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Komisionit për Sëmundje Infektive për hapjen e 'qendrave të Covid-19 [sëmundjes] që e shkakton



koronavirusi] në qytetet ku ekzistonjë tashmë spitalet e përgjithshme dhe qendrat shëndetësore. Qëllimi është të

sigurojmë trajtim të duhur për pacientët pozitivë me Covid-19, pa rrezikuar funksionimin e rregullt të spitaleve dhe shëndetin

e pacientëve të tjerë", tha Filipçë, duke përsëritur thirrjen për respektimin e masave mbrojtëse nga koronavirusi.

Kryeministri britanik u bën thirrje qytetarëve t'i kalojnë pushimet brenda vendit



LONDËR, 13 KORRIK - Kryeministri britanik Boris Johnson u ka rekomanduar qytetarëve që këtë verë pushimet t'i kalojnë brenda vendit dhe të mos udhëtojnë në zona turistike në vende të tjera. "Ky vend është i bekuar në mënyrë unike me vende fantastike për pushime", tha ai.

Vetë Johnsoni ka qenë i infektuar me koronavirus dhe për shërimin e tij është dashur

të qëndrojë në kujdes intensiv. Javën e kaluar qeveria hoqi kufizimet, që do të thotë se njerëzit që hyjnë në Angli, nga vende të caktuara, nuk do të kenë më nevojë për karantinë. Kryeministri Johnson tha se ai mendon se maskat e fytërsë "kanë një vlerë të madhe në hapësira të kufizuar" dhe se qeveria do t'i shqyrtojë "masat e zbatimit" brenda ditëve të ardhshme.

Në Mbretërinë e Bashkuara ka pasur thirrje në vazhdimësi që mbajtja e maskave të bëhet obliguese.

Mbretëria e Bashkuar është një ndër vendet më të goditura nga pandemia e Covid-19, sëmundja që shkaktohet nga koronavirusi i ri. Sipas të dhënave të Universitetit "John Hopkins", në këtë vend janë infektuar gjithsej 291 155 njerëz, ndërsa 44 904 kanë vdekur.

Përlleshje të armatosura mes talibanëve dhe forcave afgane



KABUL, 13 KORRIK - Forcat afgane të sigurisë janë përleshur me militantët në provincën veriore afgane të Samangan, pasi një makine bombë shpërtheu pranë një kompleksi qeveritar. Abdul Latif Ebrahimi, guvernatori i provincës, i tha "Radios Evropa e Lirë" se nga incidenti kanë mbetur të vrarë disa persona. Ai nuk ka sqaruar se sa njerëz mund të kenë vdekur në incident dhe kush ishin viktimat, por ka shtuar se shpërthimi ishte shumë i

fujishëm dhe madje që dridaret ishin thyer 100 metra larg. Agjencija "Reuters" citoi drejtorin e shëndetësisë së provincës, Khalil Musadeq, të thoshte se së paku 43 civilë dhe pjesëtarë të forcave të sigurisë ishin plagosur në sulm. Askush nuk e ka marrë përgjegjësinë për sulmin, por qindra anëtarë të forcave të sigurisë dhe civilë të Afganistanit janë vrarë javët e fundit nga sulmet e talibanëve.

Presidenti i Afganistanit, Ashraf Ghani, tha më 6 korrik se rritja e nivelit të dhunës paraqet një kërcënim "serioz" për procesin e paqes me talibanët. Një marrëveshje paqeje e nënshkruar nga talibanët dhe Shtetet e Bashkuara, në muajin shkurt, bën thirrje për negociata të drejtëpërdrejta midis grupit militant dhe qeverisë së mbështetur nga Perëndimi në Kabul, negociat synojnë t'i jepin fund luftës gati dydekadëshe në Afganistan.

Mbi 35 mijë të vdekur nga Covid-19 në Meksikë

MEXICO CITY, 13 KORRIK - Më shumë se 35 000 njerëz kanë humbur jetën në Meksikë nga Covid-19. Vendi i Amerikës Latine tani ka më shumë vdekje sesa Italia - një nga vendet e para që ngriti alarmin global

mbi virusin. Por, presidenti, Andres Manuel Lopez Obrador, tha të dielën se pandemja ishte "duke humbur intensitetin". Ai tha se fajin për shkaktimin e alarmit e kanë "mediat konservatore".

Ky vend regjistroi 276 vdekje të dielën dhe 4 482 taste të të infektuarve, duke çuar numrin e përgjithshëm në gati 300 000. Shtetet e Bashkuara janë ende vendi me numrin më të madh të viktimate nga

sëmundja. Pas saj radhitën Brazili dhe Britania e Madhe. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka thënë se gjatë 24 orëve të fundit me koronavirusin e ri janë infektuar mbi 230 mijë persona.



Amnezia e madhe

Përbuzje e madhe për të kaluarën, harrim i historisë dhe obsesion për të ardhmen. Pasmodernizmi që ngrihet mbi shpresën e ethshme dhe ideologjike të dëshirës për ndryshim, por që duket vetëm si maska e konformizmit më rigoroz. Po mbesim jetimë. Është "Forgetfulness", libri i Francis O'Gorman-it, docent i Letërsisë Angleze në Universitetin e Edinburgut. Shikon me trishtim dhe shqetësim çka po ndodh prej ditësh në Angli, ku statujat e lidhura me të kaluarën koloniale dhe sklavëruese të Perandorisë Britanike, janë hequr ditën për diell

BISDEDË ME: FRANCIS O'GORMAN-in
INTERVISTOI: GIULIO MEOTTI
(PËR "IL FOGLIO")
PËRKTHEU: ARMIN TIRANA

"Mendoj se ekziston një rrezik i vërtetë në bërjen e politikës së historisë, që na bën të harrojmë atë që duhet ta mbajmë në mendje", thotë O'Gorman.

"Natyrisht, nuk është e vështirë të kuptohet se pse pronarët e sklavëve dhe kolonialistët që janë objektivi aktual i protestës duhet të mos pëlqehen dhe të përfundojnë në qendër të zemërimit. Çdo herë që kaloj përparrë statujës së Oliver Cromwell-it të bërë nga Hamo Thornycroft jashtë Pallatit Uestminster, i përcmoj veprimet e Cromwell-it në Irlandë dhe kaosin që ka shkaktuar në Mbretërinë e Bashkuar, ama shkatërrimi i statujës do të ishte sikur të mos ketë ekzistuar. Sipas meje, statuja e Colston-it në Bristol dhe e Rhodes-it në Oksford mund të përfundonin fare mirë nëpër muzeume, por, të kërkosh të harrosh historinë duke ia fshirë imazhet, është rrezik i madh".

Denigrimi i së kaluarës është tashmë shenjë e një respektueshmërie intelektuale.

"Midis intelektualëve liberalë, është preferenca për një lloj të ri historie, në të cilën e kaluara duhet të shqyrtohet kryesisht për të ekspozuar dëshimet e saj. Në debate të ashpra lidhur me emigracionin dhe sulmet ndaj përvetësimit kulturor nëpër universitet, historia perëndimore fshikullohet si një zonë kriminaliteti dhe barbarie".

Është ideja, vazhdon O'Gorman, "se të gjitha kulturat janë njëlloj të pranueshme dhe për tu afirmuan në çdo moment. Ani pse në mënyrë implicate, multikulturalizmi presupozon se pasi çdo kulturë ka të drejtë që të respektohet ose, të paktën, të jetë e gjitar nga çdo gjykim, atëherë një larmi kulturosh mund të bashkëjetojë në mënyrë harmonike, në të njëjtën hapësirë, duke ruajtur identitetet e tyre. Në mendjet e intelektualëve liberalë më ekstremë, ky koncept harmonie reciproke nganjëherë është bashkuar me argumentime më të guximshme sipas të cilëve 'identitet kombëtar' dhe 'identitet kulturor' janë mite, forma vetëdijeje false ose instrumente përcarës ideologjikë".

O'Gorman flet për "sikletet nga histori" në kuptimin e vërtetë të fjalës.

"Harresa e parë qenë ndryshimet intelektuale – për të folur në përgjithësimë të mëdha – e përfshira në kalimin nga kulturat e kujtesës e Mesdheut të lashtë tek preokupimet moderne drejt së ardhmes. Greqia dhe Roma e lashtë kishin respektin e privilegjuar për të kaluarën, si motiv identiteti. Shikohet nga respekti i tyre për paraardhësit, por më gjérësisht në kuptimin e tyre të traditave lokale, të zakoneve dhe të feve të një qyteti, thelbësore për përkatesinë. Jam i pritur ta krahasoj kulturën e lashtë të kujtesës me tonën për të bërë që të shfaqet më qartë sesi është amnezia e modernizmit. Për shembull, i gjej ndryshimet intelektuale nga bota e lashtë nëpërmjet Shën Agostinit, Revolucionit Francez, lindjes së futurizmit e kështu me radhë. Por, përvëç kësaj, jam i interesuar për zhvillimet teknologjike nga fillimi i shekullit XIX e këtej, që ka inkurajuar përcaktimin e prioriteteve për të ardhmen dhe gjithnjë e më shumë indiferencën për të kaluarën. Ky është një problem i rëndësishëm pasi ka të bëjë me normat mendore, si të thuash, me të cilat jemi mësuar pa e kuptuar domosdoshmërisht për atë që na detyrojnë të bëjmë në prishjen e historive dhe traditave. Nuk dua të jem nostalgik apo idealizues.

Ka shumë gjëra në të kaluarën nga të cilat jemi të lumtur që jemi gjitar. Ama, në universitet moderne ka një lloj banalizimi të së kaluarës dhe, njëkohësisht, ndjesia se e kaluara është aty vetëm për tu kritikuar. Dominimi i ideve liberale mbi historinë ka bindur intelektualët se pozicioni më i sigurt dhe më vetafirmues ndaj së kaluarës është ai kritikues. Kjo është një ide që është ndërthurur me problemet e shkaktuara nga kthesa gjuhësore. Qëndrimet liberale ndaj studimit të arritjeve historike janë instaluar mjaftueshëm në jetën intelektuale dhe në premisat politike, kritike e kulturore të atyre që janë edukuar brenda traditës neoliberale, të cilat janë bërë thaujse të pamundura për tu vënë në diskutim.

Këto qëndrime kanë siguruar kushtin e çuditshëm e të qenit një indikator statusi, duke e problematizuar debatin pasi më i dobëti i mendjeve liberale ka ditur të mbrohet nga kritikat duke pohuar



se çdo lloj sfide, në një nivel të caktuar, duhet të jetë etikisht i dyshuar, tregues tolerance apo paragjykimi i kundërshtarit. Në rastin më të keq, kjo ka parë ndalimin më shumë sesa diskutimin, censurën në vend të analizës".

Në kohë globalizimi, kujtesa me gjithatë është vendimtare.

"Pyetet sesi do të jetë globalizimi pas Covid-19-shit. Por, problemi më i gjërë ka të bëjë me motivin për të cilin kujtesa është e rëndësishme. Komunitetet me tradita të përbashkëta, me një ndjenjë kolektive të asaj që është bërë, të asaj që është realizuar, janë më të fortë. Ajo që më preokupon tek globalizimi është ajo që preokupon njerëz të tjerë: globalizimi duket se premton shumëfishtësi, por ajo që praktikisht arrin është një konformizëm i mërziitshëm. Kujtesa na tregon përritjet e Jashtëzakonshme e të ndryshme të së kaluarës (natyrisht, kur janë të admirueshme) dhe na fut në diversitetin besafues të historisë, në çudinë dhe në praninë e saj.

Duke shikuar traditat dhe arritjet historike, nuk gjemë asgjë që të jetë thjesht statike, por realizime që janë gjithmonë të disponueshme për tu rivlerësuar, rimenduar. Sukseset e historisë nuk janë të ngrira, por na thërrasin gjithmonë që të reflektojë gjithnjë e më intensivisht lidhur me atë që e kaluara ka bërë, çfarë mund të nënkuqtojë dhe çfarë vazhdon të jetojë në mënyrë të dobishme midis të vdekurve".

O'Gorman paraqet një perspektivë psikanalitike.

"Ka kaq shumë gjëra për të thënë për Freud-in në raport me harresën. Një prej sfidave më të mëdha psikike, siç e percepton ai, është të përshtatesh me të renë. Freud-i e ka menduar nëpërmjet një miti. Dhomë e tij ishte plot me objekte religjionesh të lashta dhe mendja e tij ishte e përhithur nga aftësia potencialistë e dobishme e miteve dhe e religioneve për t'i sugjeruar mënyra mendimi të jetës dhe problemeve tona psikike. Historia e Edipit, mendon Freud, na tregon se një dëshirë për të renë është jo vetëm e lindur tek qenjet njerëzore, por edhe teatër katasfash. Diçka në jetën psikike, reflekton Freud, e bën objektin e ri me dëshirë të thellë dhe diçka që

nuk mund ta durojmë. Çfarë bëjmë me jetët tona psikike duke jetuar në kultura që vazhdojnë të na thonë se e reja është ajo për të cilën kemi nevojë dhe që duam ta dëshirojmë? Cilat janë pasojat psikike e prishjes me të kaluarën tonë në kërkimin e asaj që nuk mund të durojmë?"

Kjo risi e përhershme është një presion ndaj konformizmit.

"Qëllimi apo rastësish, ekzistonjë shumë mënyra ku kultura moderne na inkurajon të konformohemi ndaj idesë së përgjithshme se ajo që ka rëndësishës është ajo që do të vijë më pas. Në këto terma, ajo që ka vlerë është e reja. Ky prioritet për të renë ekziston edhe të mësimdhënia. Pyetja që universitetet i bëjnë para se gjithash një pedagogë është 'Çfarë ka risi në këtë mësimdhënie?' Nuk dëgjon kurrë: 'Ajo që ka kuptim'. Për të mos folur për 'ajo që është e mirë?' Dhe, po, kjo prodhon një nivel të konsiderueshëm konformizmi të fshehur nën formën e së resë".

Sipas O'Gorman-it, vet multikulturalizmi, i çuar në pasojat ekstreme, bazohet mbi këtë harresë të historisë.

"Nga njëra anë, është për mua një gjëzim i madh, së të thuash, që të ndaj kujtime kulturore që nuk janë të mët. Jam magjepsur për një kohë të gjatë nga Armenia e nga zakonet armene dhe, besoj, është një privileg që mund të njoh në mënyrë të respektuar diçka nga kultura dhe tradita të tjera. Një prej gjëzimeve të udhëtimit – kur mund ta bënim – ishte të arrije të njihje diçka nga mënyra të ndryshme të jetuari, tradita të ndryshme. Por, të paktën, sipas meje, sigurisht që ka diçka të vështirë në miratimin akritic të një noci i multikulturalizmi ideal.

Jemi kthyer sërisht në konformizëm. Multikulturalizmi propozon idenë që shumë kultura mund të jetojnë krah për krah në të njëjtën hapësirë. Kjo është një ide interesante dhe optimiste, por në praktikë mënyra ku kjo funksionon është rrafshimi i të gjitha traditave dhe kulturave në të njëjtin identitet (zakonisht konsumi). Do të ishte e gabuar nga ana ime t'i bishtnoja pyetjes, akoma më të vështirë, që ka të bëjë me humbjen e traditave kulturore dhe

identiteteve pasuese të emigrantëve.

Natyrisht, dimë se emigracioni ka qenë norma e historisë dhe një motor i madh zhvillimi i kulturës. Ama ta pranosh nuk është për të shmangur çështjen e zhveshjes kulturore, e kulturave mikpritëse që humbasin identitetin e tyre, pasi pasojat e emigracionit modern janë injoruar apo qëllimi i paraqitur keq. Debatë është aq i polarizuar sa që reflekimi lidhur me emigracionin është bërë thaujse i pamundur.

Intelektualët universitarë e kanë çuar debatin në ekstremin e majtë: e mira e 'diversitetit' është shndërruar thjesht në siguri, pa i eksploruar implikimet e tij. Për hir të së vërtetës, 'diversitet' në përvjetorin time nënkupton saktësishët të kundërtën: qëllimi i pjesës më të madhe të mbështetësve të tij është ai i bëjës së të gjithëve thjesht vetvetja. Nuk është për tu mrekulluar se pse e gjathta ekstreme ka kapur terrenin alternativ. Duke mos lejuar pyetje apo debate, intelektualët kanë krijuar hapësirën kulturore për antagonizmin e dhunshëm. Rasti im, kundër-rrymë, është që të mund të bëhen pyetje dhe të kërkohen përgjigje. Është jashtëzakonisht e vështirë të arrish ta bësh dhe shqetësohem për pasojat potenciale e refuzimit të së majtës për të shqyrtuar premisat e saj".

Së fundi, arrihet tek tema e pasidentitetit, rezultat i kësaj harrese të madhe.

"Është e frikshme për mua. Sigurisht, identitetet ndryshojnë. E mësojmë në vetë jetët tona. Për shembull, rrënjet e mia irlandezë janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe, në shkallë shumë më të gjërë, dimë se pjesa më e madhe e kulturave janë hibride në mënyra të rëndësishme: absorbimi i Greqisë nga ana e Romës; absorbimi i Venecikut me shumë tradita të ndryshme kulturore, nga Bizanti tek Austria. Ama nuk bëhet fjalë për pas-identitet. Bëhet fjalë për atë që në termat e kopshtarisë quhet 'trapiantim'. Por, fshirja, rrafshimi i thjeshtë i të gjitha identiteteve në të njëjtën formë, pa traditë, pa histori, është një rrezik psikik dhe kulturor.

Karl Marx mendonte se shteti ideal i qemisë ishte të jetonte kur historia të ishte ndalur: kur nuk do të kishte më asgjë për të shkuar, pasi asgjë nuk do të ndryshonte. Duhet të rizbulojmë një marrëveshje kolektive ku traditat janë të çmuara dhe shprehje e një identiteti. Këtu kthehet tek Freud-i. Ideja e Freud-it është se ajo që bëjmë si qenie njerëzore është se kërkojmë t'i përshtatemi humbjes së sigurisë, kërkojmë të menaxhojmë traumën që kemi qenë fëmijë, që kemi lindur. Në drithën e idesë së Freud-it, nuk jam i sigurt se po e bëjmë, duke harruar sigurinë e lidhjeve me të kaluarën. Është vërtet një formë vdekjeje kulturore".

/Bota.al/

E jashtëzakonshme

Krijesa e çuditshme mund të vlejë shumë pasuri

Një kriesë misterioze e rrallë e detit është larë në një plazh të Queensland në Australi. Një grua shpreson që një kriesë deti, e cila lahej në një plazh me rërë, mund t'i jepte asaj një pasuri të vogël. Krijesa me ngjyrë të errët mund të jetë një fenomen i rrallë dhe,



nëse verifikohet, mund të vlejë shumë para. Gruaja ndau një foto të kafshës së çuditshme që lahej në plazhin Hervey Bay në Queensland, Australi dhe mori në mediat sociale për të pyetur nëse njerëzit mendonin se ishte një mustak toksik.

FOTO E DITES



Dielli lind mbi detin Baltik në Gjermaninë veriore.

E rrallë

95-vjeçari që nuk i preu kurrë flokët, konsiderohet Perëndi në Indi

Një 95-vjeçar respektohet si Perëndi nga banorët e provincës ku ai jeton. Krejt kjo për shkak të gjatësisë së flokëve të tij gati 7.5-metërshe. Doddapalliah nuk i ka prerë asnjëherë flokët pasi që beson se do ta humbte statusin e tij si hyjni, shkruan

mediumi britanik "Daily Mail". Banorët e fshatit Chitradurga të Indisë e konsiderojnë atë të shenjtë si dhe ia mirëmbajnë flokët. Flokët e tij janë aq të gjata e të trasha saqë ndihmësve iu duhen orë të tëra për t'ia dhënë dukjen që 95-vjeçari e kërkon.



Një nigerian shumë i famshëm në Instagram falë postimeve të tij ku tregonte avionët private dhe makinat luksoze që zotëronte, është arrestuar nga FBI pikërisht falë provave të grumbulluara nga postimet në rrjetin social. Në qershor, Ramon Olorunwa Abbas, që nga ndjekësit e tij njihej si Ray Hushpuppi, u

arrestua në Dubai pasi dyshohet se është pjesë e një mashtrimi kibernetik prej rreth 400 milionë dollarë. Në Instagram ai prezanton hej si një agjent imobiliar, por fe deralët mendojnë se pasuria e tij ka ardhur si pasojë e një skeme hakerimi, prej së cilës ka vjedhur miliona dollarë nga kompani të mëdha amerikane dhe evropiane.



DASHI
Situata të harruara dhe ndoshta të

padëshiruara do të shfaqen në horizont. Bëni mirë t'i zgjidhni një herë e mirë problemet. Përballuni me fatin tuaj.



DEMI
Është koha për t'i realizuar projektet tuaja

në prite, një ndryshim rrënjesor është i mundur. Sipas horoskopit, është koha për t'ev pruar.



BINJAKËT
Nuk ka dyshim se do të ndieni emocione të

bukura dhe do ta shfrytëzoni rastin ta ngrohni zemrën tuaj në shoqëri të mirë.



GAFORRJA
Hyrja e Diellit në shenjën tuaj

përfaqëson një zgjim të vazhdueshëm. Ju ndiheni të ringjallur, projektet tuaja po fitojnë vrull dhe qëllimet tuaja varen nga pritet tuaja.



LUANI
Kjo klimë është ideale përafimet,

pajtimet dhe lindjen e një dashurie t'ë re. Përdorni pikat tuaja të forta.



VIRGJËRESHA
Urani rrit guximin tuaj, i cili bëhet një

stimul për lumturinë tuaj në të ardhmen. Ju duhet të shkonit përparrë dhe t'ë merrni një pozicion.



PESHORJA
Marsi sjell një energji që duhet të kanalizohet drejt një qëllimi specifik, një realizim konkrekt, përndryshe ju rezikonit të nervozoheni.



AKREPI
Dielli mund të përfaqësojë gjithashutu një element të forcës. Ju tejkaloni sigurinë dhe marrëdhëniet tuaja me kolegët, bashkëpunëtorët ose klientët përmirësohen.



SHIGJETARI
Nuk është kurrë vonë për t'jetuar një dashuri t'ë re. Ju nuk duhet të keni frikë nga vëtmia. Ky qill forcon sensualitetin tuaj dhe ju siguron sukses.



BRICJAPI
Jupiteri në shenjë është një mundësi e shkëlqyeshme që paraqitet vetëm qdo 12 vjet, një periudhë fati, mundësi, sukses personal ose përbushje emocionale.



UJORI
Qielli po përgatitet t'i përbushë pritet tuaja. Do të përfiton nga një karizëm i jashtëzakonshëm. Ju nuk heziton t'i ekspononi idetë tuaja për t'i zhvilluar argumentet tuaja.



PESHQIT
Kalimi i diellit ju ftot të ëndrroni dhe ta kapërceni veten. Një kohë shumë e mirë për t'epuuar përendrrat tuaja. Qartësoni objektivat tuaja.

BARSOLETA E DITËS



Tre policë para pasqyrës:

- Hej, shikoji tre kolegë.
- Shkojmë t'i përvendesim, - thotë njëri.
- Ndalo, - thotë tjetri. - Ja po vijnë vetë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Mburrej me pasurinë e tij, FBI e arreston falë postimeve në Instagram

Jada dhe Will konfirmojnë ndarjen



Will dhe Jada e kanë konfirmuar se kanë qëndruar të ndarë. Jada Pinkett Smith ka shokuar të gjithë me deklaratën e saj ku ka treguar se ka pasur lidhje dashurie me këngëtarin August Alsina, kanë shkruar mediat e huaja. Në "Red Table Talk", ku nuk mund të mungonte as Will, Jada u shpreh


se me August gjithçka nisi si miqësi e ngushtë, pasi këngëtar po vuante nga shëndeti mendor. Pinkett Smith i kishte ofruar gjithë ndihmën e nevojshme, në mënyrë që ta ndihmonte sa të mundej. Asokohe, martesa mes Jadas dhe Willit ishte në krizë dhe çifti po kalonte një periudhë kohe të ndarë.

Leonardo DiCaprio fotografohet në bregdet me të dashurën



Leonardo DiCaprio po e shijon lidhjen e dashurisë. Aktori i njohur Leonardo DiCaprio dhe e dashura e tij Camila Morrone duket se e kanë çuar në një tjetër nivel lidhjen e tyre, shkruajnë mediat e huaja. Pasi qëndruan së bashku

gjatë pandemisë, fituesi i çmimit Oscars tashmë është duke shijuar kohën me të dashurën në bregdet. Sipas "People", 45-vjeçari është duke e marrë më seriozisht lidhjen me bukuroshen brune, ku mund të pretendohet edhe për më tepër.




Jennifer Lopez dhe Maluma së shpejti me bashkëpunim

J. Lo dhe Maluma po vijnë me bashkëpunim. Dy emrat e njohur, Jennifer Lopez dhe Maluma, kanë bashkuar idetë për projektin e ri. Një gjë të tillë e ka bërë të ditur vetë këngëtarja përmes rrjetit social "Instagram", në të cilën ajo ka


pozuar së bashku me këngëtarin Maluma. Dyshja janë shfaqur me shumë stil në imazhet e postuara. Kujtojmë se J. LO ka qenë duke u izoluar së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes për shkak të pandemisë Covid-19.

Seven Saraqi në studio për këngën e re: Më e mira që kam pasur ndonjëherë



Seven Saraqi po vjen me këngë të re. Reperi i njohur shqiptar Seven Saraqi po vjen me projekt të ri muzikor. Këtë e ka bërë me dije vetë nëpërmjet disa publikimeve në rrjete sociale, madje ka treguar se kjo është kënga e tij më e mira që e ka pasur ndonjëherë. Kjo këngë do të punohet në Nju Jork, mirëpo nuk

dihet data e publikimit. Kujtojmë se emri i tij, përvèç sukseseve në muzikë, së fundmi është komentuar edhe lidhur me jetën e tij private. Flitej për një lidhje dashurie mes tij dhe Kejvina Kthellës, mirëpo kjo e fundit e ka mohuar një gjë të tillë, duke thënë se me Sevenin janë vetëm miq.



Ballkani ngushton në tri pikë diferencën me Dritën

Gara për titull është bërë edhe më interesante në Superligë, pasi Drita barazoi të dielën kundër Prishtinës dhe Ballkani të hënën fitoi kundër Feronikelit. Tash diferenca mes këtyre dy skuadrave është vetëm tri pikë.

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 KORRIK - Skuadra e Ballkanit ka treguar paraqitje të mirë dhe ka shënuar fitore në ndeshjen kundër Feronikelit (0-1). Në minutën e 33-të, Blend Baftiu shënoi golin e vetëm dhe të fitores për skuadrën nga Suhareka. Raste të tjera kishte edhe në vazhdim të ndeshjes, por rezultati mbeti i pandryshuar dhe ndeshja përfundoi me rezultat 0-1. Pas kësaj ndeshje, Ballkani është rikthyer në pozitën e dytë me 62 pikë, kurse Feronikeli është në vendin e pestë me 44 pikë. Tash diferenca mes skuadrës së Ismet Munishit dhe Dritës është vetëm tri pikë.

Në Podujevë, Llapi ka shënuar fitore pas plot gjashtë ndeshjeve në Superligë. Klubi që drejtohet nga Tahir Batatina ka arritur ta fitojë përbolljen me Flamurtarin (1-0). Pjesa e parë u mbyll pa gola, derisa në minutën e 54-t

IPKO Superliga	
Feronikeli - Ballkani	0-1
Llapi - Flamurtari	1-0
Dukagjini - Trepça '89	3-2
Vushtrria - Ferizaj	1-3
Prishtina - Drita	1-1
Gjilani - Drenica	2-0
Tabela	
1. Drita	30
2. Ballkani	29
3. Gjilani	30
4. Prishtina	30
5. Feronikeli	30
6. Llapi	30
7. Flamurtari	30
8. Drenica	30
9. Trepça '89	30
10. Ferizaj	30
11. Vushtrria	30
12. Dukagjini	30
Në xhirin e radhës takohen: Drenica-Vushtrria, Ferizaj-Dukagjini, Trepça '89-Llapi, Flamurtari-Feronikeli, Ballkani-Prishtina, Drita-Gjilani.	



elita. Llapi pas kësaj xhiroje zë vendin e gjashtë me 42 pikë, kurse Flamurtari është një pozitë më poshtë me 40 pikë. Trepça '89 ka bërë edhe një tjetër gabim që mund t'i kushtojë me rënien nga elita, pasi është mposhtur nga Dukagjini në Klinë (3-2). Vetëm dy minuta lojë i kanë mjaftuar skuadrës nga Mitrovica për të kaluar në epërsi me golin e Muhamrem Jasharit, por vendësit barazuan pas dhjetë minutave nëpërmjet Arbër Shalës. Në minutën e 13-të Milot Avdyli e riktheu epërsinë e mysfirëve, por i njëjtë futbollist në fund të pjesës së parë shënoi autogol për rezultatin 2-2. Në minutën e 72-të, Abu Kamara

vulosi rezultatin final 3-2. Këto tri pikë nuk i kanë ndihmuar asgjë Dukagjinit, pasi kjo skuadër tashmë ka rënë nga elita, derisa Trepça '89 mbetet në pozitën e nëntë me 35 pikë dhe vështirë do ta ketë sigurimin e mbijetesës në rangun më të lartë të futbollit në Kosovë.

Në ndeshjen e katërt që është zhvilluar të hënën, Ferizaj e ka mposhtur Vushtrrinë (1-3). Në ndeshjen në mes të skuadrave që në edicionin e ardhshëm do të bëjnë gara në Ligën e Parë u shënuan katër gola. Ferizaj ka grumbulluar 29 pikë pas kësaj ndeshje, kurse Vushtrria ka grumbulluar me vetëm 18 pikë nga tridhjetë ndeshje të zhvilluara.

Shtyhet Turneu Ndërkombëtar 'Lah Nimani'

PRISHTINË, 13 KORRIK - Është shtyrë Turneu Ndërkombëtar "Lah Nimani" në boks, i paraparë të organizohet më 18 korrik. Lajmi është konfirmuar sot nga Federata e Boksit e Kosovës (FboxK), e cila do t'i përfille rekomandimet dhe masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në bashkëpunim me MSh-në dhe IKShP-në).

"Federata e Boksit në rend të parë e ka ruajtjen e shëndetit të sportistëve, përkundër përgatitjeve të bëra në tërësi dhe përkundër konfirmimeve për pjesëmarrje të boksierëve nga shtetet fqinje, në konsultim me MKRS-në dhe KOK-un dhe duke përfillur rekomandimet dhe masat e Qeverisë së Kosovës (në bashkëpunim me MSh-në dhe IKShP-në), ka vendosur ta shtyjë turneun tradicional të 12 me radhë të boksit për kategoritë e reja 'Lah Nimani', i paraparë të mbahet në Prishtinë më 18 korrik", thuhet në njoftimin e Federata e Boksit e Kosovës.

Qeveria pezullon aktivitetet sportive në hapësira të mbyllur



PRISHTINË, 13 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka publikuar sot masat e marra për luftimin dhe parandalimin e pandemisë Covid-19. Ndërsa masat e shumta të publikuara sot janë edhe ato me aktivitetet sportive. Sipas njofimit, Qeveria ka ndaluar të gjitha aktivitetet sportive të cilat zhvillohen në ambiente të mbyllura. "Në vazhdim të masave të tjera të luftimit dhe

parandalimit të Covid-19, Qeveria ka pezulluar veprimtarinë e çerdheve publike dhe private; aktivitetet rekreative, kulturore dhe sportive të mbyllura në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftim. Në lidhje me këto masa, ditë më parë është zhvilluar edhe një takim i ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe ministres së

Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, me presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe drejtuesit e federatave sportive. KOK-u mbështet vendimin e ri të Qeverisë së Kosovës, derisa kërkon nga çdo qytetar i Kosovës t'u përmbahet masave të dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria për luftimin e pandemisë.

Rashica viziton FFK-në: Së bashku do të korrim suksese të reja

PRISHTINË, 13 KORRIK - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Milot Rashica, e ka vizituat Federatën e Futbollit të Kosovës ku është pritur nga kryetari Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm Eroll

Salihu. Po në takim të pranishëm ishin edhe ndihmëstrjneri Muhamrem Sahiti dhe kryetari i "Dardanëve", Lulzim Berisha. "Drejtuesit e FFK-së e përgëzuan Milotin për paraqitjet e mira në Bundesliga" n

edicionin e sapopërfunduar, teksa uruan që ai të realizojë një transferim dhe kontratë sa më të mirë gjatë kësaj vere. Në anën tjetër, Rashica u shpreh falënderues për pritjen dhe përkushtet fantastike që i ka kri-

juar kryetari Ademi dhe FFK-ja për ekipin përfaqësues. Ai ka shprehur besimin se edhe në të ardhmen do të vazhdojnë së bashku për korjen e sukseseve të reja", thuhet në njoftimin e FFK-së.



Të mërkurën fillon afati kalimtar në hendball

PRISHTINË, 13 KORRIK - Afati i rregullt kalimtar për hendballiste dhe hendbollistë për edicionin 2020/21 do të fillojë të mërkurën, më 15 korrik, dhe do të vazhdojë deri më 31 korrik, në përputhje me Rregulloren mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusin dhe transfer-

transferimin i tyre. Të drejtën e paraqitjes së kërkesave për regjistrim e kanë të gjithë ata lojtarë dhe lojtare që nuk kanë kontrata valide me skuadrat e tyre, apo me marrëveshje të skuadrave, sipas Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusin dhe transfer-

imin e tyre. Kurse për lojtarët që vijnë nga skuadrat jashtë territorit të Kosovës, regjistrimi mund të bëhet deri në fund të muajit shkurt, konform rregulloreve të Federatës Evropiane dhe asaj Ndërkombëtare. Lojtarët të cilët aplikojnë për statusin e lirë sipas Rregullores

mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusin dhe transferimin e tyre, kanë të drejtë regjistrimi deri më 15 tetor 2020, mirëpo paraprakisht duhet aplikimi për statusin e lirë dhe mund të shfrytëzohet afati përfundimtar i 15 tetorit 2020.



Ronaldo kërcënnon Lewandowskin për 'Këpucën e Artë'

TORINO, 13 KORRIK - Cristiano Ronaldo është rikthyer si një përbindësh pas pezullimit të kampionateve. Portugezi ka shënuar në të gjitha ndeshjet që kur Seria A u rikthye dhe tani numëron 28 gola në kampionat. Një ecuri e tillë ka bërë që ai të jetë vetëm një gol larg Ciro Immobiles në tabelën e golashënesve të kampionatit italian dhe vetëm 6 nga Robert Lewandowski, i cili është lideri në tabelën e "Këpucës së Artë". Por Ronaldo e kërcënnon seriozisht sulmuesin polak të Bayernit sepse në Serinë A kanë mbetur edhe 6 javë të tjera për t'u luajtur. Kjo do të thotë se Cristiano Ronaldo mund të fitojë "Këpucën e Artë" për herë të pestë në karrierën e tij. Kjo gjë dukej shumë e vështirë dhe e pamundur kur u rikthye futbollit, por portugezi ka shënuar 7 gola në 6 ndeshjet e luajtura për Juventusin në këtë periudhë: Një Bolonjës, një Leçes, një Genoas, një Torinos në derby, një Milanit dhe dy të fundit kundër Atalantës me penallti. Shtatë gola, 4 me penallti për ta arritur kuotën e 28 golave në total. Cristiano Ronaldo nuk e ka fituar "Këpucën e Artë" që nga sezoni 2014-2015 kur shënoi as më pak dhe as më shumë se 48 gola në La Liga me



Realin e Madridit. Që nga ajo ditë, Luis Suarez dhe Leo Messi në 3 raste kanë qenë fituesit. Ronaldo nuk është shfaqur as në podiumin e këtij trofeu në 3 sezonet e fundit. Ndeshjet që i kanë mbetur Ronallos për ta kaluar Lewandowskin janë kundër Sassuolos, Lazios, Udineses, Sampdorias, Cajlarit dhe Romës. Me Serinë A thuajse të përfunduar dhe pa rivalitet, duket se objektivi kryesor i të gjithë skuadrës është që Cristiano Ronaldo të dalë golashënesi më i mirë në kampionatin italian dhe në Evropë. Ashtu si Ronaldo, edhe Immobile mund ta parakalojë Lewandowskin, sepse kampionati

gjerman ka përfunduar. Një "lufte" që pritet elektrizuese deri në javën e fundit duke qenë se diferenca mes "Zonjës së Vjetër" dhe Lazios tashmë është 8 pikë dhe duket se nuk ka më garë. Në këtë sezon, Ronaldo ka arritur të shënojë në total 32 gola, 28 në Serinë A, 2 në Ligën e Kampionëve dhe 2 në Kupën e Italisë. Interesant është fakti që 6 golat e fundit të shënuara nga Ronaldo kanë qenë nga goditje standarde ose penallti. Vetëm një herë e kishte bërë diçka të tillë në vitin 2009 kundër Unitedit. Portugezi është një hap larg historisë me Juventusin pasi për 2 gola do të barazohet me Borelin, i cili në vitin 1934 shënoi 31.

CAS-i ia shfuqizon dënimin Cityt

MANCHESTER, 13 KORRIK - Manchester City do të luajë në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm pasi Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (CAS) e ka shfuqizuar dënimin me dy vjet pezullim nga futbolli evropian për klubin anglez.

UEFA e dënoi Cityn me dy vjet pezullim nga garat evropiane në shkurt të këtij viti për shkelje të rënda të rregullave për ndershëmëri financiare dhe licencim të klubit. Klubi i Premierligës i pati mohuar akuzat në mënyrë ta vazhdueshme dhe të ashpër dhe muajin e kaluar vendosi të ankohej ndaj dënimit e CAS. Pas një seance dëgjimore



që zgjati tri ditë në muajin qershor, CAS-i ka vendosur tani që t'ua heqë dënimin të kaltërve. Kjo nënkupton se City do të jetë i lirë të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm, pasi e ka siguruar një vend në garën më prestigjioze evropiane, duke qenë se e siguroi vendin e

dytë në Premierligë të shtunën pas fitores 5-0 ndaj Brightonit. Ndërsa dënimini me gjobë prej 30 milionë eurosh i është ulur në 10 milionë euro. Në një komunikatë për media pas vendimit, CAS thuhet: "Shumica e akuzave për shkelje të raportuara nga dhoma gjykuese e Institucionit për Kontroll Financiar të Klubeve (CFCB) i UEFA-s ishin të pabazuara apo me limit të skaduar kohor. Nuk ishte i drejtë shqiptimi i një dënimit për ndalim pjesëmarrjeje në garat për klube të UEFA për Manchester Cityn vetëm sepse dështoi të bashkëpunojë në hetimet e CFCB-së".

Turan pas 9 sezonesh rikthehet te Galatasaray

Arda Turan do të rikthehet ta veshë fanellën e Galatasarayt pas 9 sezonesh. 33-vjeçari, i cili nuk luan që prej dhjetorit të kaluar kur u largua nga Basaksehiri, pas një pezullimi të

gjatë nga Federata, ka arritur pajtimin me drejtuesit e Galatasarayt për një kontratë njëvjeçare me të drejtë rinovimi edhe për një vit tjetër. Në kushtet e një pandemie globale mësohet

se Arda Turan ka firmosur një kontratë në varësi të performancës. Ai do të paguhet rrëth 26 mijë euro për çdo ndeshje të luajtur dhe 500 mijë euro bonus nëse ekipi do ta fitojë titullin.

SHKURT

Werderi refuzon ofertën e Leipzigut për Rashicën

Werder Bremen ka refuzuar një ofertë që ka bërë RB Leipzig për yllin e Kosovës, Milot Rashica. Oferta prej 15 milionë eurosh, plus tre milionë shështë në bonuse, është vlerësuar e pamjaftueshme, njofton "Bild". Werderi po kérkon së paku 25 milionë euro për Rashicën. Rashica këtë edicion ka shënuar 11 gola dhe i ka asistuar tetë të tjerë në 34 ndeshje në të gjitha garat.

Bartomeu: Messi dëshiron ta përfundojë karrierën në Barcelonë

Tifozët e Barcelonës ende janë në ankth pasi kapiteni i tyre, Lionel Messi, po futet në vitin e fundit të kontratës. Ylli argentinës i skadon kontrata me Barcelonën në verën e vitit 2021, ndërsa ende nuk ka pranuar rinovimin me klubin. Gjithsesi ka qenë presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, që është përkujdesur për t'i gjëzuar tifozët katalunas, duke thënë se janë duke biseduar me Messin për rinovimin e kontratës. "Ne kemi folur, po flasim dhe do të vazhdojmë të flasim me Messin për vazhdimin e kontratës. Messi dëshiron ta përfundojë karrierën te Barcelona. Ne patjetër do të rinojmë me të dhe unë nuk kam dyshime për këtë", ka thënë Bartomeu.

Kloppi e ka ndërmend të qëndrojë gjatë në Liverpool

Jurgen Kloppi ka vendosur të largohet nga Liverpooli sapo t'i mbarojë marrëveshja me klubin në vitin 2024. Trajneri gjerman synon të qëndrojë në Anfield deri në përfundim të kontratës, e cila i zgjat deri në verën e vitit 2024, pastaj të rikthehet në atdhe. 53-vjeçari nënshkroi marrëveshje të re me të kuqtë në dhjetor të vitit 2019, duke ia kushtuar klubit të ardhmen, dhe vetëm disa muaj më vonë ia fitoi edhe titullin e parë në ligë pas plot 30 vjetëve. Përveç titullit në Premierligë së fundmi, Kloppi e udhëhoqi Liverpoolin edhe drejt fitimit të trofeut në Ligën e Kampionëve dhe Kupën e Botës për Klube sezonin e kaluar. Sfida me të cilën përballet Kloppi tani është ta shtojë këtë sukses në vitet në vazhdim. "Katër vjet në Liverpool", ka thënë Kloppi, i pyetur se sa gjatë e ka ndërmend të qëndrojë në Angli. E i pyetur nëse e ka për qëllim të rikthehet në Gjermani, trajneri i të kuqve është përgjigjur: "Patjetër, për të jetuar pasi ta përfundoj karrierën. Më shumë mundësi në Mainz".

Vritet vëllai i lojtarit të njohur të Premierë Ligës

Gazeta e njohur britanike "The Sun" raporton se në orët e para të mëngjesit të sotëm është ekzekutuar me armë zjarri në Francë, Christopher Aurier. Viktima është vëllai i ylli të njohur të Tottenhamit, Sergio Aurier. Nuk dihen shkaqet që kanë çuar deri te ngjarja, mirëpo raportohet se kryesi i veprës ka shkrepur disa plumbë në trupin e Christopherit në mëngjesin e sotëm në Toulouse. Ai vdiq më pas në spital. Christopher ka qenë, po ashtu, futbollist, ndërsa këtë edicion po luante në ligën e tretë franceze te skuadra Rodeo. Christopher Aurier njihej si person problematik. I ndjeri në vitin 2017 ishte arrestuar pasi kishte grabitur një prostitutë.

C.nr.596/13
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil, si gjykatë civile e shkallës së parë me trupin gjyques të përbërë nga gjyqtari Nazmi Neziri dhe sekretaren juridike-procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridiko civile të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine magjistrala Prishtinë Fushë Kosovë rr. "Lidhja e Pejes" të cilin e përfaqëson e autorizuara e saj Faik Sylejmani, me autorizim, kundër të paditurit Mursel Miftari nga Podujeva me adresë rr. "Xhafer Meta", tani me adresë të pa njohur diku në Gjermani, baza e kontestit për Rimbursim demii, duke vodosur sipas propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në shqyrtimin përgatitorë më datë 03.07.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

Caktohet si përfaqësues i përkohshëm Mahmut Hoti, avokat nga Podujeva, për të paditurit Mursel Miftari nga Podujeva me adresë rr. "Xhafer Meta", tani me adresë të pa njohur diku në Gjermani.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë i saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të publikohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një nga gazetat e shtypit ditor në Kosovë, dhe një kopje i dërgohet Qendrës për Punë Sociale në Podujevë.

A r s y e t i m


I paditurit Mursel Miftari nga Podujeva me adresë rr. "Xhafer Meta", tani me adresë të pa njohur diku në Gjermani, ndërsa nuk ka përfaqësues të autorizuar, andaj i autorizuari i paditësit Faik Sylejmani në seancën e shqyrtimit përgatitorë të mbajtur pranë kësaj gjykatë ka propozuar që të njëjtit i caktoset përfaqësuesi i përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë të saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga e gjitha kjo u vendos si në dispositiv të këtij aktvendimi konform nenit 79.1, 81.1 dhe 83 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
C.nr.596/13 më dt.03.07.2020

Gjyqtari :
Nazmi Neziri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykatës.

Certified translation from Albanian language

C.no.596/13

BASIC COURT IN PRISHTINË – BRANCH IN PODUJEVË, General Department-Civil Division, in the quality of first instance civil court comprised of Judge Nazmi Neziri and legal assistant – minute keeper Afërdita Ejupi in the matter of the claimant Kosovo Insurance Bureau seated in Prishtinë, regional road Prishtinë-Fushë Kosovë Lidhja e Pejës Street, represented by duly authorized representative Faik Sylejmani against the respondent Mursel Miftari from Podujevë, Xhafer Meta Street, current address unknown somewhere in Germany, pertaining to damage reimbursement, upon deciding pursuant to the claimant's proposal for the appointment of the provisional representative in the preliminary hearing on 03.07.2020 renders the following:

RULING

Mahmut Hoti, attorney from Podujevë is appointed as the provisional representative of the respondent Mursel Miftari from Podujevë, Xhafer Meta Street, current address unknown somewhere in Germany.

Pursuant to Article 82 of the LCP (Law on Contested Procedure) the provisional representative has all the rights and obligations of a legal representative until the respondent or his duly authorized representative does not appear before the court, namely until the custody authority notifies that court that its has appointed a custodian.

This Ruling shall be posted in the court's announcement board and shall be published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in one of the daily newspapers in Kosovo, and one copy shall be serviced to the Center for Social Affairs in Podujevë.

Reasoning

The respondent Mursel Miftari from Podujevë, Xhafer Meta Street, current address unknown somewhere in Germany, has no duly authorized representative, therefore the claimant's duly authorized representative Faik Sylejmani in the preliminary hearing conducted before this court proposed to the same to appoint a provisional representative.

Pursuant to Article 82 of the LCP (Law on Contested Procedure) the provisional representative has all the rights and obligations of a legal representative until the respondent or his duly authorized representative does not appear before the court, namely until the custody authority notifies the court that it has appointed a custodian.

Based on the foregoing, it was decided as in the enacting clause of this Ruling pursuant to Articles 79.1, 81.1 and 83 of the LCP.

BASIC COURT IN PRISHTINË – BRANCH IN PODUJEVË
C.no.596/13 on 03.07.2020

Judge:
Nazmi Neziri
[Stamp and signature]

LEGAL REMEDY:

Within 15 days from the day this Ruling is serviced, through this court, the unsatisfied party may file an appeal against this Ruling with the Court of Appeals in Prishtinë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË –DEGA PODUJEVË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI-OGRANAK U PODUJEVU-BASIC COURT OF
PRISTINA-BRANCH IN PODUJEVO

C.nr.596/13
Datë:03.07.2020
P o d u j e v ë

Në bazë të nenit 83 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, kërkojmë që të publikoni këtë:

SHPALLJE

Gjykata Themelore Prishtinë-Dega Podujevë, në çështjen kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine magjistrala Prishtinë Fushë Kosovë rr. "Lidhja e Pejes" të cilin e përfaqëson e autorizuara e saj Diellza Hajdari me autorizim, kundër të paditurit Mursel Miftari nga Podujeva me adresë rr. "Xhafer Meta", tani me adresë të pa njohur diku në Gjermani, **Rimbursim demii**, në bazë të nenit 79.1, të LPK-së, të paditurit: Mursel Miftari nga Podujeva me adresë rr. "Xhafer Meta", tani me adresë të pa njohur diku në Gjermani, **me aktvendimin C.nr.596/13 të dt.03.07.2020**, në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm i ka caktuar Mahmut Hoti, avokat nga Podujeva, i cili do ta përfaqësojë të paditurin, në këtë çështje kontestimore, deri sa ai apo i autorizuari i tij të paraqitet në këtë gjykatë.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
C.nr.596/13 më dt.0..07.2020



Certified translation from Albanian language

[Coat of Arms of the Republic of Kosovo]

[Court Logo]

REPUBLIC OF KOSOVO
BASIC COURT IN PRISHTINË – BRANCH IN PODUJEVË

C.no.596/13
Date: 03.07.2020
Podujevë

Pursuant to Article 83 of the Law on Contested Procedure (LCP), we kindly ask you to publish this:

ANNOUNCEMENT

Basic Court in Prishtinë – Branch in Podujevë, in the contested matter of the claimant Kosovo Insurance Bureau seated in Prishtinë, regional road Prishtinë-Fushë Kosovë Lidhja e Pejës Street, represented by duly authorized representative Diellza Hajdari, against the respondent Mursel Miftari from Podujevë, Xhafer Meta Street, current address unknown somewhere in Germany, pertaining to **damage reimbursement**, pursuant to Article 79.1 of the LCP: with its **Ruling C.no.596/13 of 03.07.2020** has appointed Mahmut Hoti, attorney from Podujevë, as the provisional representative of the respondent Mursel Miftari from Podujevë, Xhafer Meta Street, current address unknown somewhere in Germany. The provisional representative shall represent the respondent in this contested matter until the respondent or his duly authorized representative does not appear before the court.

BASIC COURT IN PRISHTINË – BRANCH IN PODUJEVË
C.no.596/13 on 03.07.2020

Judge:
Nazmi Neziri
[Stamp and signature]

SHPALLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" Magure

Ndërmarrja e Re (N.R.) "MIM Golesh", Magure e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, **SHPALLË** këtë:

FTESË PËR OFERTË

PËR SHITJEN E MATERIALVE

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"

ADRESA POSTARE: Magure

I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

- Dunit I thërrmuar, fraksion 0 – 4mm , rrëth 13800 m³,
- Dunit I thërrmuar, fraksion 4 – 8 mm , rrëth 2500 m³,
- Dunit I thërrmuar, fraksion 8 – 11 mm rrëth 1100 m³ dhe
- Shkëmbinj ultrabazik (material përmbyshje), fraksion – 60 mm , rrëth 36700 m³.

II. KUSHTET E OFERTIMIT:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresë. Oferta duhet të përbaj çmimin me TVSH, duhet të jetë shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë ti shikojnë prej datës 07.07.2020 deri me 12.07.2020 prej orës 10:00h deri në orën 14:00h përmes personit kontaktues z. Shefik Imeri, nr. tel mob. 049/455-869 ose fix. 038/588-700.

IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES:

- Çmimi më i lartë i ofruar përm³ të materialit

V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të janë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **13.07.2020** nga ora **13⁰⁰** deri në orën **14⁰⁰** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

Ofertat do të hapen me datë **13.07.2020** në ora **14¹⁰** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.

Lumé's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Salon Depilimi Lumé's Details
lumesdetails
Albropa Teatr iL, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje përvjetore



[facebook](#)

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► S"Studio 654" SH.P.K. shpallo të pavlefhshme certifikatën e biznesit me nr. 810846264.

► Jap banesë me qira afér 60 m², katil III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katil dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katil dytë me ngrohje, klimë, ashensore etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian katil i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katil i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përbanim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentishët kërkoi një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katil tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a blue box lists the "Quality & Sales Award Recipients" in alphabetical order. To the right, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle.

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



The advertisement features a tin of Meka Pashtetë Pule (liver pâté) against an orange background. The tin is circular with a yellow label. The label includes the Meka Halal Food logo, the product name "PASHTETË PULE", a "gluten free" badge, a "no no mish pul" badge with a chicken icon, and a gold ribbon banner at the bottom that reads "ciliësi e garantuar". Below the banner is the text "pa konservues". The tin shows a slice of the pâté with herbs and a red pepper.